

BIBLIOTEKA E RINISË

TU QEPEMI

854-32

T 95

KODRAVE

E MALEVE

891-983-32

T. 95

5

BIBLIOTEKA E RINISË

---

BIBLIOTEKA E SHTEPI  
GJYKONJ

40072

T'U QEPEMI  
KODRAVE E MALEVE

3249

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

**«T'U QEPEMI KODRAVE E MALEVE,  
T'I ZBUKUROJMË E T'I BËJMË ATO  
PJELLORE SI EDHE FUSHAT»**

Për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, krahas me luftën për intensifikimin, duhet të ndiqet për një kohë të gjatë edhe rruga e hapjes së tokave të reja. Vendi ynë, ndonëse me relief të theksuar malor, ka akoma rezerva të mëdha për të zgjeruar sipërfaqet e mbjella me drithra buke e bimë të tjera bujqësore. Këto rezerva gjenden në përgjithësi në lartësi e në zona të thella. Prandaj edhe sytë për hapjen e tokave të reja duhet t'i drejtojmë nga kodrat e nga malet.

Duke e vlerësuar drejt e me frymë revolucionare rëndësinë e kësaj rezerve të madhe në bujqësi, me ndjenjë të thellë përgjegjësie ndaj interesave jetike të popullit e të socializmit, për sot e për të ardhmen, në këtë pesëvjeçar partia shtron si objektiv të parë hapjen e 115.000 hektarëve toka të reja.

Nuk ka asnjë dyshim se kjo direktivë e partisë dhe detyra e caktuar në këtë pesëvjeçar për hapjen e tokave të reja do të zbatohen me sukses në jetë. Mjafton të përmendim se vetëm gjatë vitit të parë të këtij pesëvjeçari u hapën rreth 30 përqind më shumë toka të reja, se sa janë hapur gjatë dy vjetëve të fundit të pesëvjeçarit të tretë, të marrë

së bashku. Ky fakt përmbys edhe parashikimet më të guximëshme në këtë drejtim.

Është detyrë e organizatave të partisë që vru-llin revolucionar të fshatarësisë sonë patriote që shpërtheu për hapjen e tokave të reja në vitin e parë të këtij pesëvjeçari, ta mbajnë të gjallë dhe ta ngrënë në një shkallë edhe më të lartë.

.....

Me hapjen në shkallë të gjërë të tokave të reja në këtë pesëvjeçar e në pesëvjeçarët e ardhëshëm zonave kodrinore e malore u hapen perspektiva të mëdha e të ndritura zhvillimi. Parulla e partisë, e pushtetit dhe e gjithë popullit duhet të jetë: **«T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat».**

.....

Zhvillimin e bujqësisë në male partia dhe pushteti duhet ta mendojnë e ta studjojnë me vemendje të madhe, në mënyrë të organizuar. Ata duhet të bëjnë në këtë drejtim një punë këmbëngulëse, të mos kënaqen me pak dhe të mos entuziazmohen shpejt nga sukseset, sepse në këtë ndërmarrje madhështore e të pashëmbëlltë në historinë e vendit tonë do të hasen edhe vështirësi e pengesa, të cilat duhet dhe do të kapërcehen me siguri.

Hapja e tokave në kodra e male, qysh në këtë pesëvjeçar, duhet të bëhet sipas një plani perspektiv, i cili të parashikojë sa toka, ku e kur do të hapin fshatarësia dhe kooperativat bujqësore dhe sa toka, ku e kur do t'i hapë shteti, duke pasur parasysh

që tokat e reja që do të hapen nga shteti të përbëjnë masive unike, mbi bazën e të cilave të mund të ngrihen ferma shtetërore.

Organet e partisë e të pushtetit duhet të zgjidhin problemin e krahut të punës për këto ferma. Cilat mund të jenë rrugët e zgjidhjes? Natyrisht, një burim e përbën fshatarësia e zonave malore, por duke e ditur mirë qysh tani se kooperativat malore do të kenë nevojë vetë për më shumë krahë pune, prej tyre nuk duhet pritur ndonjë gjë e madhe. Një burim tjetër duhet siguruar nga kooperativat e fushave. Për këtë qëllim, gjatë 10-vjeçarit të ardhshëm ne duhet të përpioemi për mekanizimin maksimal të punimeve bujqësore në fushë, në mënyrë që të lirohet këndeje një numër i madh krahësh pune për të kaluar në male. Por burimi kryesor për të populluar fermat malore në përgjithësi duhet të jetë popullsia e qyteteve dhe në radhë të parë rinia, e cila është e guximëshme, patriote, entusiaste dhe gjithënjë u përgjigjet direktivave të partisë.

Zhvillimi në këtë rrugë i bujqësisë sonë jo vetëm do të sjellë shtimin më të madh të prodhimeve bujqësore, pra krijimin e rezervave të konsiderueshme, por do të ndihmojë edhe për normalizimin e shpërndarjes së drejtë të popullsisë. Ngjitja në male do të zhdukë tendencën e dëmshme, antiekonomike, mikroborgjeze e burokratike që vihej re për të zbritur në qytet, pavarësisht në se këtë e lypnin ose jo nevojat e ekonomisë.

Duke zbatuar këto orientime, malet tona, tani disi të braktisura e të varfëruara, brenda një kohe jo të largët do të lulëzojnë e do të bëhen pjellore. Vendin e zbukuron njeriu dhe malet do t'i transformojnë dora e mendja e njeriut.

.....

Populli këtë aksion kolosal do ta presë me entuziazëm, sepse në të ai do të shohë një të ardhme të madhe. Partia ka besim të madh veçanërisht tek rinia, e cila do t'i përgjigjet me entuziazëm thirrjes së partisë dhe do t'u qepet maleve, e ndërgjegjëshme se kështu lufton për begatinë e atdheut, për krijimin e fshatrave e qyteteve të reja në male, për përhapjen kudo të kulturës e të përparimit, për shkrirjen e qytetarëve me fshatarët. Rinia, e ardhmja e vendit tonë, do të kalitet me frymë komuniste dhe me tiparet heroike të malësorëve tanë, ajo do të bëhet e çelniktë si vetë malet tona.

*(Nga raporti i shokut Enver Hoxha,  
mbajtur në Kongresin e 5-të  
të P.P.SH. bot. II. f. 64, 65, 66.)*

## MIQ NGA FUSHA

Një xhade çan brinjët e maleve dhe të shpie lart, lart.

Rreth e rrotull male. Tani që është dhjetor malet çdo ditë e çdo orë ndrojnë mjergullat: herë hedhin mbi supe një mjergull më të hollë, herë një mjergull më të dendur. Malet çohen fare pranë njëri tjetrit. Nga kjo lartësi, duken në rrjesht majat e tyre. Duket sikur janë mbledhur kokë më kokë, të gjithë të ashpër, po të bukur, me shkëmbinjte dhe pjerrësiat e tyre. Vetëm njëri nga malet duket sikur është ngjallur e zbutur, sikur e ka humbur rreptësinë e vëllezërve të tij. Populli, që nuk le gjë pa i vënë emër, e quan këtë «mali pilaf».

Ca ndërtesa të vogla prej guri; një tjetër ndërtesë dykatëshe me kulm të pjerrët, majë kodrës përballë, ja kjo është qendra e lokalitetit të largët të Terpanit. Shtëpitë e fshatit Terpan janë krejt të shpërndara. Proverbi «fshati që duket s'do kallauz», mund të ketë lindur në çdo vënd, por vetëm jo në këto anë, sepse këndeje fshatrat nuk duken.

Gjer para ca kohësh Terpani ka qenë shumë i qetë, si çdo fshat i shpërndarë. Por dhjetori i vitit 1966 ja prishi qetësinë. Një ngjarje e re që s'kish ndodhur më parë e tundi. I erdhën miq nga fusha.

Por miqtë nga fusha nuk ishin as krushq, as

shokë, as të njohur denbabaden. Këta ishin djem e vajza të fushës, të rinj dhe të reja të kooperativës së Lapardhasë dhe të kombinatit Mao Ce Dun që vinin vullnetarë, për të ndihmuar vëllezërit e tyre të malit.

Këta ishin miq jo të zakonshëm. Për herë të parë mikpritjes tradicionale shqiptare, jeta i shtoi një veti të re të miqësisë. Jeta dhe realiteti revolucionar lindin gjithmonë fenomene të reja në situata të caktuara, zbërthejnë energji të panjohura, zbulojnë rezerva të reja pasurish shpirtërore. Të brumosur me këto veti të reja dhe të frymëzuar nga vendimet e Kongresit të 5 të PPSH, këta të rinj e të reja erdhën në Terpan, për të hapur toka të reja dhe taraca; për të punuar në ndihmë të kooperativave malore.

Ndihma për tjetrin, është një gjë e vjetër sa vetë bota dhe shqiptari nuk e ka lënë kurrë jashtë udhëtarin që e zë nata në rrugë, por që një fshat i tërë të ndihmojë një tjetër, që një kolektiv i madh punëtorësh të ndihmojë një kolektiv të madh fshatarësh, fusha të ndihmojë malin dhe për një kohë kaq të gjatë pa shpërblim, kjo është një gjë e re. Kjo gjë përbën një element, që i kapërcen kufitë e marrëdhënieve të zakonshme të jetës sonë, ajo është një element i jetës komuniste. Lenini thotë se komunizmi fillon atje ku njeriu i zgjat dorën njeriut. Inisiativa e këtyre të rinjve është vazhdimi i traditës së bukur të luftës, kur partizanët e ndanin kafshatën e bukës me njëri tjetrin, ajo ka lidhje me aktin e komunistit hero Adem Reka, me gjithçka të bukur dhe heroike që krijohet sot tek ne, qoftë kjo në mal, në fushë apo në det.

Fusha ka ardhur mysafire në male. Fusha do të



sjell diçka nga fytyra e saj në relievin e rreptë malor. Për një kohë tjetër, kjo do të ishte një gjë e pabesueshme.

Po ja që fusha erdhi.

Ajo erdhi për t'i dhënë malit ndihmën e saj, për t'i dhënë malit dhe njëkohësisht për të marrë diçka nga fytyra e malit. Fusha, krahas ndihmës për hapjen e tokave, po e ndihmon malin të flakë ndonjë paragjykim. Pikërisht këtu qëndron bukuria e asaj që ndodhi në Terpan në dhjetor.

Në dimër zakonisht terpanakët nuk punonin. Ata shkonin për gosti tek njëri tjetri, i a shtronin me muhabet e këngë. Por ja erdhën këta të rinj të Lapardhasë, erdhën këto vajza qytetare të Kombinatit «Mac Ce Dun», filluan punën, në mes të dimrit, për të hapur toka të reja dhe taraca. Terpanakët nuk mund të turpëroheshin por dolën të gjithë në punë bashkë me miqtë. Ata punojnë tani bashkë, hanë bashkë, këndojnë bashkë dhe flenë bashkë. Të ardhurit janë ndarë dy nga dy nëpër shtëpitë e fshatarëve si dikur partizanët. Pas pune vajzat ndihmojnë gratë fshatare në punët e shtëpisë, u mësojnë ndonjë gatim të ri, u qepin ndonjë fustan. Vetë ardhja e këtyre të rejave nga larg, sjelljet e tyre, janë një ndihmë për shoqet e tyre fshatare. Në dhjetor, femrat e Terpanit filluan të respektohen më shumë nga burrat. Fanatikët u zunë ngushtë. Kapadajitë ngelën me gisht në gojë. Vajzat e fshës punonin njësoj si djemtë, ndoshta dhe më tepër, në të ftohtë, në shi, në mjergull.

Por fusha çfarë merr nga fytyra e malit? Edhe ajo merr shumë gjëra, po mbi të gjitha, fusha mëson se ç'do të thotë të bësh bukë në mal. Fusha mëson.

se me sa mundime bëhet buka në male, me sa mundime hapen taracat dhe tokat e reja.

Mbrëmjeve miqtë mblidhen bashkë me vendësit në shtëpitë e fshatarëve dhe ahëre fillon përzierja e këngëve, e shakave, e tregimeve. Fusharakët këndojnë ndryshe, malësorët ndryshe. Fusharakët — myzeqarçe, malësorët — vënçe.

Në një nga këto mbrëmje të paharrueshme u dëgjuan midis këngëve të reja që kishin nxjerrë vulnetarët dhe vendësit edhe këto dy vargje:

*Terpani dhe Lapardha*

*U bënë motër e vëlla.*

Uniteti nuk është një fjalë e zbrazët. Ai realizohet nëpërmjet qindra çfaqjeve të tilla të jetës dhe të realitetit revolucionar. Dhe atë që populli e ka në jetë, i pëlqen që ta hedhë sa më shpejt në këngë. Kështu bashkë me këngët e tjera me motive fare aktuale, për Kongresin e pestë, për parullën «t'u qepemi kodrave e maleve», për Adem Rekën; bashkë me qilizmat e porsa hapura, lindën dhe këta dy rrjeshta të thjeshtë, këtu në Terpanin e largët, në muajin e ftohtë të dhjetorit.

Lufta e njeriut për të mbrojtur tokën ka qenë e përjetëshme. Por kjo ishte një luftë e vetmuar, kasma e tij ishte e vetmuar, ashtu siç ishte e vetmuar pushka e tij.

Tani mijëra njerëz kudo, një ushtri e tërë, po bëjnë taracimin e tokave. Taracimi është një gjë e domosdoshme për tokat e reja, taracimi është mbrojtja e tyre. Të hapësh toka të reja në vende të rrëshqitëshme dhe të lësh pas dore taracat, është

njëlloj sikur t'ia çosh vetë ujkut delen tënde. Sepse tokën e hapur, erozioni e përulan më shejpt.

Në raste luftrash mali na ka mbrojtur shumë. Përsëri në raste lufte mali do të na mbrojë. Por këtë herë jo vetëm do të na mbrojë, këtë herë ai do të na japë edhe bukën. Pikërisht për këtë **arësye hapja e tokave të reja, vajtja e të rinjve të fushës** në ndihmë të maleve, zbatimi i parullës «t'u qepemi kodrave e maleve», nuk janë aksione të thjeshta të lindura si rezultat i llogarive të ekonomistëve. Ato janë në radhë të parë aksione të thella politike. Ato i lindi vetë jeta dhe revolucioni, kanë lidhje me esencën e tij, me parimet themelore të jetës sonë.

## INISIAIVE DHE AKSION I MADH REVOLUCIONAR

Ç'forcë i nxitë të rinjtë e Lapardhasë t'u ngjiten maleve të Terpanit; ç'i shtyn ata të punojnë pa shpërblim në ndihmë të kooperativave malore? Ishin idetë frymëzuese të Kongresit të 5-të të Partisë, që u kthyen në mendjet e këtyre të rinjve në një forcë materiale e revolucionare. Në tribunën e Kongresit të 5-të shoku Enver, duke iu drejtuar gjithë popullit dhe veçanërisht rinisë tha: «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». 10 ditë më vonë, nga Lapardhaja e Beratit, 160 të rinj e të reja, me inisiativën e tyre, të inkuadruar në brigada vullnetare, iu ngjiten maleve të Terpanit dhe në gërxhet e tyre ngritën flamurin e punës komuniste. Ata punuan për hapjen e tokave të reja në kondita të vështira atmosferike, e me një punë entuziaste realizuan normat mesatarisht çdo ditë mbi 115 përqind. Ishte kjo një përgjigje flakë për flakë thirrjes së partisë, shkëndija e parë e një aksioni të madh revolucionar, që vuri në plan të parë politikën, që nuk mori parasysh interesin personal, dhe vështirësitë, por para së gjithash e mbi çdo gjë, vuri interesin e përgjithshëm, punën në dobi të shoqërisë.

Ky gjest i të rinjve të Lapardhasë pasqyron

një ndërgjegje të lartë. Si punë e bërë pa shpërblim në dobi të shoqërisë, ajo përmban në vetvehte elementët e çmuara të punës komuniste. Shëmbuj të tillë, të nxjerrë nga jeta e gjallë, të lindura nga inisiativa e masave, kanë një vlerë të madhe edukuese dhe mobilizuese në punë. Në vitin 1919, Lenini duke vlerësuar si një inisiativë të madhe «të shtunat komuniste», të organizuara nga proletariati i Moskës, thoshte se «ato kanë një rëndësi të madhe historike, sepse ato na tregojnë inisiativën e ndërgjegjshme dhe vullnetare të punëtorëve për ta shtuar rendimentin e punës, për të kaluar në një disiplinë të re në punë». E shtuna komuniste nënvizonte Lenini i madh, «është një nga celulat e shoqërisë së re socialiste». Në këtë prizëm duhet ta shohim dhe ta vlerësojmë edhe inisiativën e Lapardhasë. Në plenumin e komitetit të rinisë së Beratit, të mbledhur në malet e Terpanit, u tha se ky shëmbull midis të shumtëve, i ngjan atij kallirit në një fushë me grurë që e rrit shtatin më lart se të tjerët. Duhet ta marrim farën e këtij kalliri dhe ta mbjellim kudo.

Cilat janë aspektet më të rëndësishme që përcaktojnë aksionin e të rinjve të Lapardhasë si aksion ideologjik?

Kryesorja është se këta të rinj, siç shprehen ata vetë, i dhanë një goditje të rëndë interesit të ngushtë personal, mposhtën egoizmin mikroborgjez të trashëguar nga regjimet shfrytëzuese dhe sipas të cilit njeriu mendon: «Të rroj unë, pa për të tjerët aq më bën». Pra, esenca revolucionare e mendimeve dhe qëndrimit komunist të të rinjve të Lapardhasë dhe e të gjithë atyre që e përqaftuan këtë lëvizje, qëndron në faktin se këtu u çfaq me të

gjithë madhështinë kujdesi plot vetmohim i punonjësve të thjeshtë për të rritur rendimentin në punë, për të rritur qoftë edhe një kilogram drithë apo produkt tjetër, i cili, siç thoshte V.I. Lenini, nuk shkon në dobi të vetë këtyre punonjësve, as në dobi të njerëzve të tyre «të afërt», por në dobi të njerëzve «të largët», dmth të të gjithë shoqërisë. Kjo është ana më e rëndësishme e kësaj inisiative dhe pune revolucionare. Por jo e vetmja: me inisiativën e tyre, të rinjtë revolucionarë të Lapardhasë dhe ata që e përqaftuan atë zgjidhën një sërë problemesh të tjera, revolucionarizuan mendimin dhe veprimin e malësorëve tanë, hodhën poshtë në mënyrë revolucionare një sërë konceptesh konservatore që ekzistonin në malësi lidhur me prodhimin dhe mënyrën e jetesës atje. Aty këtu thuhet se «në mal nuk jetohej», se «toka që kemi nuk mjafton as për gjysmën e popullatës që banon këtu», por të rinjtë po e tregojnë me punë se jo vetëm ka rezerva kolosale për të hapur toka të reja, por edhe se si duhet shfrytëzuar e mirëmbajtur ajo tokë që ekziston. Aksion-llogari: kjo ishte metoda e punës. Bile kjo metodë pune nxorri se në Terpan jo vetëm nuk janë të tepërt krahët e punës, por se për ta punuar si duhet tokën që ekziston, duhen krahë të tjerë pune. Ky është një mësim tjetër për të rinjtë e kooperativave malore. Fryma e shëndoshë, optimiste e revolucionare që është ngjallur, duhet të ngrihet më lart, ajo të shërbejë për mobilizimin në punë në kooperativat malore, të të rinjve dhe të gjithë fshatarësisë së këtyre zonave, për të marrë në dorë zgjidhjen e problemeve që preokupojnë kooperativat malore. Këtë duhet ta kenë mirë parasysh organizatat e rinisë, të cilat, me një

punë të thellë ideologjike e bindëse, të bëjnë një mobilizim të plotë të të gjithë krahëve të punës, duke hedhur poshtë mendimin se «tani do të na vinë këta të fushës për të na ndihmuar» dhe të lihen shpresat këtu. Kjo është e dëmëshme dhe duhet luftuar atje ku mund të çfaqet.

Në pamje të jashtëme, fakti që anëtarët e BRPSH-së dhe të rinjtë e Lapardhasë morën me vete bukën dhe ushqimin që do të hanin gjatë një muaji, ndokujt do t'i dukej e tepërt. Por çështja nuk qëndron këtu, ajo është më e thellë. Duhet të thyhet mendimi që ekziston në disa zona të malësisë se bukën na e jep shteti, pa u menduar aspak se kush është shteti dhe ku e merr ai. Një koncept i tillë ka ngjallur një pasivitet në fshatarin e malit ndaj problemit të bukës, duke menduar në mënyrë shumë të shtrembër se punuaka ose jo, shteti nuk e lë pa bukë. Shteti tek ne është i popullit, është vetë populli. Inisiativa e shokëve të Lapardhasë konsiston: buka të sigurohet vetë, të çlirohet shteti nga kjo barrë e rëndë.

Inisiativa e të rinjve të Lapardhasë, e mbështetur nga të rinj të tjerë të fushës të rrethit të Beratit dhe rretheve të tjera, bëri që t'i shpallet një luftë e ashpër një farë plogështie që ekzistonte në malësi, theu monotoninë, mposhti konceptin e gabuar, thellësisht konservator e reaksionar, se gjoja në malësi dimrit nuk mund të punohet. Ajo vërtetoi se si dimri mund të kthehet në stinë pune, bile pune të atillë vendimtare që përcakton në një shkallë të madhe prodhimin bujqësor, në dimër mund të hapet toka — mjeti kryesor i prodhimit bujqësor, në dimër mund të mbillen pemët — përsëri mjeti kryesor për shtimin e prodhimeve në frutikulturë, në dimër

mund të bëhet pyllëzimi — mjeti kryesor në luftën kundër erozionit, etj. etj. Ja pra, të rinjtë e Lapardhasë dhe shokët e tyre, me inisiativën për t'iu ngjitur malit në periudhë dimri, e treguan me punë këtë realitet. Edhe këtu qëndron forca e kësaj inisiative. Ajo i ka bërë, dhe duhet t'i bëjë pa tjetër, në mënyrë të veçantë të rinjtë e fshatrave malore dhe tërë fshatarësinë e këtyre zonave, të shohin në mënyrë revolucionare qëndrimin e vet ndaj punës sidomos gjatë dimrit, kur ata pothuajse nuk punonin fare.

Me inisiativën e tyre të rinjtë po i japin goditje rutinës, spontanitetit mikroborgjez, duke dhënë një shëmbull se si duhet organizuar puna në kooperativat bujqësore, qofshin ato edhe të fushës, me një eksperiencë të pasur disavjeçare. Aksioni i të rinjve të fushës që iu qepën malit vërtetoi se metoda më e mirë e punës është përqëndrimi i forcave në objekte të caktuara. Kjo e bën të mundshëm masivitetin në punë, zbatimin e rregullave, siguron daljen dhe lënien e punës në orar të caktuar, rrit kërkesat ndaj cilësisë së punimeve, rrit entuziazmin e gjallërinë dhe rendimentin në punë. Ky është një mësim tjetër, të cilin e vlerësojnë edhe në kooperativat malore. Le të sjellim një shëmbull: Në kooperativat e Terpanit e të Tozharit, në rrethin e Beratit, të dyja kooperativa malore, puna fillonte vonë në mëngjez. Por të rinjtë e Lapardhasë gjatë kohës së aksionit që kryen në Terpan, ora 7 e mëngjezit i gjente në fushë. Ndërsa në Tozhar, duke u përqëndruar forcat vullnetare dhe ato kooperativiste, brenda dy ditëve u mbollën mbi 10 ha me grurë. Kjo mënyrë pune, pra, theu monotoninë e zakonshme, i vuri pjerëzit në sedër që të marrin pjesë



gjallërisht në punë dhe në orarin e caktuar, të thyejnë normat, të cilat deri dje, për shkak të plogështisë mikroborgjeze, dukeshin të paarrtë-shme.

Rëndësia e kësaj inisiative përcaktohet nga fakti se ajo u shndrrua shpejt në një lëvizje të gjërë të bazës, që lindi në përgjigje të vendimeve të Kongresit të 5-të të partisë; ajo shtroi me forcë një kërkesë të ligjëshme të masave për një disiplinë të re në punë, për një organizim të ri të saj. Kjo është shprehja e lartë e inisiativës së masave, e disiplinës së tyre të re, e cila në rendin tonë socialist përbën çfaqjen më të lartë të demokracisë. Kjo është demokraci në veprim, mendim dhe veprim i masave të lira, pa bujo. Kjo është ajo demokraci në të cilën, siç theksonte V. I. Lenini, ka më pak fraza të mëdha dhe më tepër punë të thjeshtë, të përditëshme, më tepër kujdes për kuintalët e drithit, më tepër kujdes që ky kuintal drithi dhe qymyri për të cilët kanë nevojë punëtori dhe fshatari, të mund të sigurohet jo me anë spekulimesh tregëtare, jo me mjete kapitaliste, por me punën e ndërgjegjëshme dhe heroike të pashëmbullit të punonjësve. Baza e kësaj discipline të re, e rilindjes, forcimit dhe zhvillimit të saj, është heroizmi i masave të gjëra punonjëse në dobi të socializmit. «Kur të jetë konsoliduar plotësisht fitorja mbi rutinën, çthurjen dhe egoizmin, thoshte V. I. Lenini, do të zhduket çdo mundësi për t'u kthyer prapa në kapitalizëm dhe komunizmi do të bëhet me të vërtetë i pathyeshëm. Kjo është detyra më e vështirë, sepse ajo nuk mund të zgjidhet në asnjë mënyrë me heroizmin e një çasti të vetëm, por kërkon

3249 - 40272  
MARTIN LUTHER KING  
LIBRARY

heroizëm më të gjatë, më këmbëngulës dhe më të vështirë, heroizmin e punës së përditëshme dhe në masë.»

Duke e vlerësuar lart iniciativën e organizatës së rinisë së Lapardhasë, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH, e dekoroi atë me urdhërin «Për shërbime të shquara shtetërore e shoqërore» të klasisit të parë. Ky është një nder i madh, një nxitje frymëzuese jo vetëm për të rinjtë e Lapardhasë, por për mbarë rininë e vendit tonë.

Ne shohim me gëzim sot, se shëmbulli i iniciativës së rinisë së Lapardhasë po shndërrohet në një lëvizje masive. Mijëra të rinj e të reja fshatarë e punëtorë nga Berati e Korça, Vlora e Gjirokastra, Shkodra e Fieri, Lushnja e Durrësi, etj. u janë ngjitur kodrave e maleve, me një ndjenjë të thellë përgjegjësie për misionin e madh që i caktoi parti, me një frymë të lartë revolucionare për t'i shërbyer interesave të vëndit dhe të shoqërisë, atje ku puna është më e vështirë. Kjo lëvizje tregon ç'rezerva kolosale energjie e vullneti fshihen në gjirin e rinisë, për të shndërruar planet madhështore të partisë në vepra të gjalla, dhe ç'forcë të madhe tërheqëse kanë lëvizjet që lindin nga gjiri i masave.

Rinia i ngjitet maleve e bindur dhe e ndërgjyeshme se kështu lufton për begatinë e atdheut. Nën udhëheqjen e partisë ne kemi realizuar suksese të mrekullueshme në të gjitha fushat e jetës. Suksese të tjera na presin. Por rruga jonë e zhvillimit dhe e përparimit nuk është e sheshtë dhe as e shtruar në asfalt. Ne kemi përpara detyra të reja e të vështira, që për t'u kaluar kërkojnë bindje të thella politike, sakrifica dhe guxim revolucionar. Zhvillimi i bujqësisë në male është një nga këto detyra, është

një ndërmarrje madhështore, e pa shëmbullt në historinë e vëndit tonë, për realizimin e së cilës do të hasen edhe pengesa, edhe vështirësi, që do të kapërcehen me siguri. Në këtë aksion të madh politik, rinia ndjen detyrën e saj historike, për të lulëzuar malin, këtë aleat të madh, fisnik e bujar, që ka qënë e do të mbetet kështjella jonë e pamposhtur.

Ky aksion duhet të bëhet sa më masiv. Duke mobilizuar dhjetra mijra të rinj e të reja në brigadat vullnetare, organizata jonë i dërgon ata në një shkollë të vërtetë edukimi revolucionar. Dhe s'ka shkollë më të madhe edukimi se sa aksioni në punë për të mirën e gjithë shoqërisë.

Nëpërmjet kësaj lëvizjeje masive organizata jonë manifeston dashurinë e saj të madhe për punë e prirjen për t'u hedhur në vepra të guximëshme, atje ku e thërret partia. Me dërgimin e vullnetarëve të rinj fshatarë e punëtorë, në male, do të forcohet fryma e solidaritetit dhe e miqësisë luftarake midis rinisë së fushës dhe rinisë punëtore nga njëra anë, dhe asaj të malësisë nga ana tjetër. Aksioni do t'i afrojë këta të rinj, ai do të ndihmojë sadopak në realizimin e detyrës së madhe të çdukjes së dallimeve midis fshatit fushor e atij malor, midis qytetit e fshatit, e do të kontribuojë që edhe fshati malor të ecë me ritme të shpejta drejt socializmit. Aksioni do ta ngrejë në një çështje nderi parimin e lartë komunist të vënies së interesit të përgjithshëm mbi interesin e ngushtë personal.

Një anë tjetër e vlerës së aksionit është se vullnetarët do të japin shëmbullin e mirë të organizimit dhe disiplinës që kanë kooperativat e zhvilluara fushore dhe ndërmarrjet industriale. Të rinjtë që do të shkojnë në vullnetarë, do të tregojnë në male këmbënguljen

për të punuar edhe në kondita të vështira atmosferike, organizimin e mirë në punë dhe disiplinën. Mobilizimi i gjithë forcave të rinisë dhe i gjithë kooperativistëve në punë, do të jetë një detyrë e madhe e vullnetarëve.

Por ky aksion do të jetë në të njëjtën kohë një shkollë revolucionare për edukimin e vetë vullnetarëve. Malet ruajnë tradita të çmuara të atdeshdashurisë. Aty është zhvilluar historia më e lavdishme e luftës nër liri. Këto tradita e kjo histori janë shumë të nevojshme për edukimin e rinisë. Nga ana tjetër, konditat relativisht më të vështira të malit, do të kalisin mijra të rinj, e do të bëjnë që ata të punojnë e jetojnë si revolucionarë.

## DREJT MALEVE PËR NË KOOPERATIVAT E REJA

*U hap lajmi në Tiranë*

*Dhe parulla se ç'u hodh...*

Janë dy vargje të një kënge, që lindi fushave të Lapardhasë. Me këtë këngë ata iu qepën maleve të Terpanit... Më vonë prej andej u shkruanin familjeve për punën që kryenin dhe mikpritjen malësore që gjetën. Në këtë shkrim do të flitet jo më për inisiatorët, por për të tjerët, që muarën të tjera rrugë malore.

### I.

Legjenda thotë, se u ngrit Tomorri dhe goditi Shpiragun e pabindur me shpatë. Që atëhere ai mbeti vija-vija... Po mbi pejsazhin e maleve të Shpiragut, arat e punuara duken si arna të qepura mbi rroben e një trupi gjigand. Në shënimet e një ditari thuhet: «Më 28 nëndor forcat vullnetare të brigadave të rinisë të nisura nga kooperativat fushore, ju qepën maleve, për të punuar një muaj. Disa u nisën në Terpan, të tjerë në Osmanzezë, në Planisht e në Çorrogjaf, Roshnik, Tozhar...». Dhe mbi shpatullat e maleve do të qepet një rrobë e re.

## Bijtë e fushës

U nisën nga kooperativa e bashkuar e Poshnjes për rrugë të largët, 58 djem dhe 27 vajza. Në 50 km. rrugë, vullnetarët i prin flamuri i aksionit. Organizatën e rinisë së tyre Presidiumi i Kuvendit Popullor, me rastin e 25 vjetorit të themelimit të BRPSH-së, e dekoroi për punën e mirë. Punën e vet ata do ta tregojnë dhe këndej maleve.

— Mirseardhët miq!

Kooperativistët, tre-katër orë larg më këmbë, kishin dalë për të pritur vullnetarët. Ata u marrin valixhet e torbat vajzave, bijave të fushës, dhe prijnë përpara, si zotët e shtëpisë.

Rruga e vështirë. Thonë se edhe derri i egër, dikur, nuk çante dot në këto rrugë. Vendi quhej vendi i ujërve. Ja këndej, këtyre maleve po ngjiten këta, por tani në një rrugë tërë baltë, ku kanë kaluar traktorë, në disa pika të kërkimeve gjeologjike. Këto male tona të pasura do të japin edhe bukë. Vullnetarët e parë shkelën këmbë...

## Në Osmanzezë

Fshati është mjaft i shpërndarë, i ndërtuar në faqet e pjerrta të disa bogave. Ai ka rreth 130 shtëpi të gurta, të mbuluara me rrasa. Lartësia më e madhe e maleve të Osmanzezës është 948 m. mbi nivelin e detit. Vendi është i mbuluar me shkurre dhe gurë. Këto shkurre do të shkulen nga rrënjët e në vend të tyre do të mbillen drithra buke. Në të ardhmen njerëzit s'do të mbledhin gurë, por prodhimet e tyre bujqësore.

Kooperativa e Osmanzezës është e re: thujse ka dy muaj që është formuar. Dhe kryetari i kësaj kooperative është i ri, në detyrën e vet. Ai më parë ka qenë shef i seksionit të bujqësisë së rrethit të Beratit, dhe duke iu përgjigjur thirrjes së partisë, shkoi në fshat për të drejtuar këtë kooperativë. Dhe vullnetarët janë të rinj. Ata i presin simbas traditës:

### Bukë e kripë e zemër

Jakupi ka gruan dhe fëmijët. Darkën e 28 nëndorit mori rrugën sëbashku me dy bija të fushës dhe, mbas një ore, u gjend te pragu i shtëpisë.

— Mirseardhët!

Mikeshat përshëndoshen, si të niohura prej ditësh, si të pritura prej kohësh. Rreth zjarrit vendësit pysin për fushën e mikeshat mësojnë për malet me gurë... Të zotët e shtëpisë s'dinë ç'bëjnë për t'i pritur sa më mirë.

— Sonte jeni mikështa, nesër e tutje jeni të shtëpisë, prandaj... — i qetësonin me fjalët më të ngrohta. — Ju keni ardhur të punoni me ne.

Natën e arritjes, te Karamani bujtën tri vajza, me qëllim që të nesërmen, njera prej tyre të kalonte te fqinja. Po ja që të nesërmen ai bëri fjalë me shokët e kryesisë:

— Shtëpia ime ka qenë gjithmonë e hapur për miqtë, jo tre, por dhe pesëdhjetë sikur të ishin...

Tre shoqet për një muaj do të jenë pjestare të asaj familjeje.

Këtu, ndër të tjera, treguam vetëm dy shëmbëlla të bujarisë shqiptare: nën dritën e kandilave,

rreth zjarrit, në shtëpi të gurta njerëzit çdo darkë bisedojnë...

### Çdo të sjellë e nesërmja

Vajtja e këtyre vullnetarëve në zonat malore nuk është thjesht për të hapur tokë të re, për të shkukur vetëm shkurre e gurë nga këto male. Kooperativa e Osmanzezës është e re. Sigurisht anëtarët e saj nuk janë mësuar me punën e përbashkët, dhe, gjatë kohës, do të fitojnë përvojën.

Fushave kooperativistët kanë bërë si rregull që punën ta fillojnë shpejt, në orët e para të natës, pa pritur lindjen e diellit. Po këtë rregull punë ata nuk e gjetën në kooperativën e porsa formuar. Duhej kërkuar rruga për të kursyer çdo minutë të kohës. Dhe rruga, thua se, dalëngadalë po merr drejtimin e vet: Çdo mëngjez, forcat vullnetare, të shpërndara në gjashtë brigadat e kooperativës, nisen për të punuar sëbashku me vendësit në hapje tokash të reja. Në të gjithë kooperativën dalin 250 forca vendase në punë se, «kur punon miku, është turp që i zoti i shtëpisë të qëndrojë për t'u marrë me punë vetiake».

Dhe aty, gjatë punës, ata nxiten prej njëri-tjetrit. Kanë ndarë vendin e hapin garë kuësh do të punojë më tepër. Pra në çdo brigadë, organizohet informacioni politik dhe ky, kurdoherë lidhet me punën konkrete të kooperativës. Në fletë-rrufetë, të dala në çdo pesë ditë nga shtabi i brigadave, paraqiten problemet që dalin, vështirësitë e hasura dhe kapërximi i tyre, të dalluarit gjatë punës, etj.

Jetën e organizatës vullnetarët me të rinjtë



vendas e bëjnë sëbashku. Kjo do të vlejë së tepërmi për shkëmbimin e eksperiencës së të dy organizatave, për forcimin e mëtejshëm të tyre.

Në planin tematik të aktiviteteve, që do të kryhen këtu gjatë një muaji, përfshihen programe artistike, një mbrëmje tematike për të luftuar mbeturinat e së kaluarës dhe zakonet prapanike në krahinë, ngritja e pesë shtëpive model, pranime në organizatën e rinisë, etj.

## II

E lemë krahinën e Shpiragut dhe hidhemi përtej në Plashnikun 2, kufi me të është Plashniku 1. Këto dy kooperativa i përkasin zonës së Terpanit. Në hartë tregohet se lartësia më e madhe arrin në 974 m...

Duke shkuar drejt lartësive, andej nga krihen retë, je i detyruar të kalosh përrenj ujë pakët, të përshkosh rrugën shkëmbore, e rrugë buzë rrëpirave, që nesër s'dihet në janë, se po ranë shira të rrëmbyeshëm, faqja e malit rrëshqet dhe ato humbasin. Pra kësaj ane nuk është e nevojshme vetëm të hapen toka të reja, duke e bërë qilizëm me 40 cm. thellësi, por dhe të mbillen drurë për mbrojtje nga erozioni. Në këto male kanë ardhur vullnetarët e Kutallisë.

Po të vështrosh nga kodra në kodër do të shohësh njerëz që mihin tokën. Ata kanë kaluar në punë duke kënduar këngë revolucionare. Gjithsejt në Planisht — dhe kjo kooperativë e re, që s'ka dy tre muaj që është formuar janë 75 vetë. Midis tyre ndodhen dhe bijat e fushës.

Në një shënim të një të riu, shkruar para mbritjes, ne lexojmë: «...Kur u nisëm nga Berati, sekretari i komitetit të partisë të rrethit, si na uroi rrugë të mbarë, na porositi, që kudo të shpërndajmë eksperiencën e përparuar, kudo të shpiem fjalën e partisë dhe, me punën tonë, të bëhemi shëmbull...».

Dhe ata arritën në Planisht. Që në ditët e para norma filloi të realizohet. Ka të rinj që çdo herë i tejkolojnë normat në përqindje të konsiderushme.

Natyra kësaj ane është e njëjtë, si ajo e Osmanzezës: për t'u mposhtur kërkon vendosmëri, këmbëngulje, vrull rinor.

125 të rinj të tjerë, vullnetarë të Kutallisë janë vendosur në Plashnik 1.

Le të ndjekim disa çaste pune, të një karakteri të ndryshëm nga ato që kryejnë zakonisht vullnetarët në këto male.

Ja, aty në atë ultësirë, sëbashku me kooperativistët punojnë 13 të rinj e të reja. Ata bëjnë sistemin e vijave kulluese. Janë stërvitur në këtë punë, se dhe në kooperativën e tyre me këtë punë janë marrë prej vjetësh. Ata punojnë me mjaft kujdes, dhe shpërndajnë në këtë zonë malore përvojën e vet të disa vjetëve.

Në një vend tjetër punojnë 72 vetë. Ata hapin gropa për mbrojtje nga erozioni dhe mbjellin në to akacie. Përpara se të fillonin këtë punë, bashkërisht me rininë e fshatit, lexuan materialet e botuara për mbrojtjen nga erozioni. Teknikët e pyjeve kanë ngelur mjaft të kënaqur nga cilësia e punës së vullnetarëve.

Në planin e aktiviteteve pas punës është përcaktuar të njohin nëpërmjet takimeve me pleqtë

e veteranët e luftës, të kaluarën e fshatit, luftën e tij, jetën e tij.

Jeta dhe puna, që bëjnë vullnetarët në këto anë, do të vlejë për mbarëvajtjen e këtyre kooperativave të reja.

### III.

Të 706 të rinjtë vullnetarë, 600 nga këta të kooperativave fushore, dhe 106 të qendrave të ndryshme të punës së qytetit të Beratit, janë shpërndarë kudo në zonat malore. Ne tani do të ndjekim në punë të rinjtë e kooperativës së Goriçanit, vendlindjes së heroit të popullit, të riut ushtarak, Hajdar Tafa. Vendi i punës së tyre janë dy Zhitomet: Zhitomi i Madh dhe Zhitomi i Vogël.

Territori i Zhitomit është mjaft i madh, dhe ashtu si thonë vendësit fillon nga Droboniku e mbaron në Terpan: vetëm ta përshkoh atë gjatë rrugës automobilistike të duhet një ditë në këmbë, aq i gjerë e i shpërndarë është vendi. Thonë se ky vend i rrit shumë qershitë dhe ullirin, por, për çudi, këndeje nuk sheh blloqe të qershive e të ullirit, por shkurre, drurë dhe gurë. Ja këtu kanë ardhur të punojnë 85 vullnetarët e Goriçanit, pa iu trembur vështirësive të natyrës dhe gërrmojnë tokën, gjithmonë gërrmojnë...

### Në erë e në shi

Gjatë kohës vendësit janë përpjekur të nxjerrin nga vendi i gurtë, misrin e grurin. Në ndihmë të kësaj kooperative filluan punën 34 të rinj e të reja; të tjerët ndodhen në Zhitom të Vogël. Ata janë të

ndarë simbas brigadave të kooperativës në tre grupe dhe ndodhen larg nga njëri tjetri thua se një orë e gjysëm-dy.

Brigada e parë punon te korija e Miçinakut. Vendi ka qenë më i egër se tani, vend ku shëtisnin derra të egër, dhe banonin shpesë të egra. Aty vendësit kullosnin bagëtitë.

Këtu pra, sot, punojnë me brigadën e parë dhe 12 të rinj e të reja vullnetarë: presin dëllinja e mare, hapin qilizëm, duke shkukur drurë nga rrënjët, hedhin mënjanë gurët, do të bëjnë brezat mbrojtës dhe toka «e gurtë» do të kthehet në tokë buke.

Aty pranë punës, ata kanë ngritur dhe një kasolle, në mënyrë që të mos largohen kur të fillojë shiu.

Ja shiu fillon me rrëmbim. Vullnetarët hyjnë nën strehët e «ndërtesës së re». Koha fillon të zbutet, ata marrin kazmat dhe dalin në punë. Kjo është jeta e përditëshme e tyre. E në këtë jetë të përditëshme ata kanë organizuar dhe aktivitete.

### Në mbrëmjen e së djelës

Të rinj e të reja u mblodhën në vatrën e kulturës. Ata kishin punuar gjithë ditën e djelë, dhe në darkë, të 85 vetët, kishin vendosur të kalonin sëbashku çaste çlodhjeje. Ishte e djela e parë mbas fillimit të punës.

Bijtë e maleve dhe të fushave kërcejnë sëbashku vallet popullore; këndojnë këngët e trimave dhe këngët e punës. E ndruajtur e reja malësore, përfshihet në gazin e valles, se aty pranë saj ndodhet ajo mikësja e ardhur nga fusha, e cila gjatë këtyre

ditëve i është bërë si motër në shtëpi. Është ajo e re, që para dy ditësh mësoi nga mikeshja e vet një qëndizme të bukur, që mori e nisi të thurë modelin e një trikoje, të pa përdorur në këto anë.

### **Male të larta!**

Vetë karakteri i punës, që kryejnë vullnetarët, u ka dhënë mësimin e madh të jetës, që asnjë herë të mos epen përpara vështirësive. Ata u nisën drejt maleve. Seicili kishte marrë me vehte dhe veglën e punës. Përpara u priu flamuri i aksionit.

**Male të larta!**

Perpara vrullit rinor, thyhen gurët, se ata janë më të fortë se shkëmbi, shkulen drurët, se motivet që i shtynë në vepra heroike kanë rrënjë më të thella, se rrënjët e drurëve ndër shkëmbinj.

## ASHTU SI PARTIZANËT

*(Çaste nga nisja e vullnetarëve)*

### Fillimi

E mërkurë, 14 dhjetor 1966.

Në këndin e kuq të fabrikës së letrës në Lushnjë buçiti kënga e të rinjve. Mbledhje të organizatës së rinisë në fabrikë ishin bërë dhe të tjera herë, por jo me një entuziazëm të tillë. Kësaj radhe mbledhja kish një karakter tjetër. Ata kanë vendosur që në rrethin e Lushnjës të jenë inisiatorët për t'iu qepur maleve, gjatë eskursioneve të ndryshme, por kësaj radhe ata do të shkojnë për të punuar atje.

Kur sekretarja e komitetit të rinisë së fabrikës njoftoi se disa antarë të Bashkimit të rinisë kishin propozuar që të shkonin si organizatë e të punonin 15 ditë në ndonjë kooperativë malore, salla oshëtiu nga duartrokitjet, thirrjet për Partinë dhe shokun Enver.

Një i ri propozoi:

— Të shkojmë në dispozicion të rrethit të Skraparit.

— Në qafën e Kulmakut, tha një tjetër, kurse Shpresa tha:

— Kallot do të duken në duart tona më bukur nga byzylykët dhe unazat e stolisura. Aty ndër male ne me kazmën tonë do të ndihmojmë për ndërtimin e jetës së re socialiste.

Ajo i ftoi shokët dhe shoqet të shkonin në ndihmë të kooptivës bujqësore të Therepelit, atje ku prindërit e tyre, njëzetedy vjet më parë, themeluan Brigadën e 16-të sulmuese, në përbërjen e së cilës shumë qenë myzeqarë.

Shpresa është ende e re, sa i ka mbushur të 18 vjetët. Në punë është e kujdesëshme, e urtë, e dashur me shoqet dhe nga duart e saj del prodhim me kualitet të lartë. Ajo është edhe aktiviste e dalluar në punët shoqërore, ajo bën pjesë në grupin teatral të fabrikës.

Filloi regjistrimi. Seicili nxitonte të ishte ndër të parët. Kur papritur hapet porta dhe hyn brënda një djalë esmer. Ai i drejtohet presidiumit:

— Me lejë shokë! Unë sot fillova lejën e zakonëshme dhe nuk di asgjë për mbledhjen, por dëgjova dhe erdha. Unë dua të them se lejën e zakonëshme dëshiroj ta kaloj së bashku me shokët e mi, në Therepel.

Kaq tha ai dhe u ul. Shokët e përgëzuan për këtë gjest revolucionar.

Mbasi u regjistruan të 134 të rinjtë e të rejat për të shkuar vullnetarë në tokat malore, u paraqit vështirësia se kush do të punonte në fabrikë, ku thuajse gati të gjithë puntorët janë të rinj. Mbasi u rrahën mendimet u vendos që të shkohej në dy turne: 60 veta në turnin e parë, e ata që do të mbeteshin të plotësonin dhe detyrat e prodhimit në fabrikë, duke kryer edhe punën e shokëve.

Sekretari i organizatës bazë të Partisë pyet:

— Kush del vullnetar për të qëndruar në fabrikë e të shkojë në turnin tjetër?

Në sallë ra heshtja.

— Si thua ti Petrit?

— E lemë në dorë të komitetit që t'i caktojë turnet dhe, përsa më përket mua, unë do të shkoj tani se kam lejën dhe s'keni se si më ndaloni. Në sallë shpërtheu gazi, që u mbulua nga duartrokitjet.

• • •

E enjte 15 dhjetor 1966!

Në orët e para të mëngjezit në oborrin e fabrikës kishte lëvizje të madhe. Kishin dalë gjithë punonjësit për të përcjellë vullnetarët. Ata i përshëndeti drejtori i fabrikës, partizani veteran i Myzeqesë, shoku Lili. Pastaj kolloha e vullnetarëve e inkuadruar në skuadra e kompani, u nis për në qendër të qytetit.

Ishin çaste me të vërtetë të bukura e prekse, kur kollona e vullnetarëve, me flamurë rë duar e duke kënduar, po hynte në qytet.

Shumë kujt i kujtohet kur nisej çeta partizane në aksion se si mblidheshin fshatarët për t'i përcjellë. Edhe në Lushnjë ashtu u bë. Sheshi buçiste nga kënga e vullnetarëve, që së bashku me popullin formonin një kor madhështor:

*Bashkohu shokë me ne në çetë*

*Malit të lart të shkojm përpjetë...*



Ata kënduan së bashku dhe këngën

*Në njërën dorë kazmën,  
Atdheun ndërtojmë,  
Në tjetrën dorë pushkën,  
fitorët i mbrojmë...*

Atë ditë në qytet ishte vërtet festë e madhe.

Me flamurin përpara, në të cilin ishte shkruar emri i të riut Miti Çakalliu, kollona e vullnetarëve nisët duke kënduar.

Ja, ata të 60 vullnetarët ecin përpara. Ne të gjithë ecim përpara. Dhe atdheu i prirë nga partia ecën përpara nga fitorja në fitore.

## NE MALET E SKRAPARIT

...E lamë Therepelin e po i ngjiteshim lartësisë për të vajtur te vullnetarët. Në kodër, te Qafa e Shkozës, ku janë bërë luftime të ashpra, ndaluam e hodhëm sytë përtej nga Vokopola, e ku syri të zinte vetëm male, pyje e kodra. Me të kaluar Qafën e Shkozës, përpara na doli pllaja e pjerrtë ku ndodheshin 60 të rinjtë e të rejtat. Ata punonin me vrull revolucionar. Malet vërtet janë të ashpër, por të bëjnë për vete. Këndej ka lindur dhe kënga e tyre, një këngë e re, kushtuar partisë, që i armatosi me frymë revolucionare. Ndër vargjet e saj thuhet:

*...Na dhe krahë e na dhe jetë  
Të shkojm maleve, përpjetë...*

Aty janë dy kompani të ndara në gjashtë skuadra, po kjo, skuadra e dytë e kompanisë së dytë qëndron në krye të punëve. Ajo ndihmon shumë edhe skuadrat e tjera për çkuljen e kërçepëve të mëdhenj. Komandantja e kësaj skuadre, Lumturia ishte vetë e para që kthente tërë ata kërçepë të rëndë. Ajo flet me admirim edhe për shoqet, Lutfien, Sheqeren, Gorin. Vullnetarët e kësaj skuadre punojnë si myzeqarë të vërtetë, të mësuar me punë.

— T'ua rrëmbejmë tokën maleve të egër e t'i bëjmë pjellore si fushat, thoshte Gori, duke rrukullisur ata kërçepë.

Të tjerët pasonin.

Gurë, rrënjë, kërçepë, siç janë malet, i tillë ishte edhe terreni ku punonin vullnetarët e ardhur nga Lushnja. Ata ndesheshin me vështirësitë. Hiqen gurët e shkurret dhe vendi ngelet i pastër, gadi për t'u mbjellë.

Ndoqa me vëmëndje punën e një komunisti të ri. Ai i ishte qepur një kërçepi të madh dhe qëllonte mbi të me kazmë ashpër, për të mposhtur ashpërsinë e terrenit. Violeta, komandante e kompanisë së dytë më shpjegoi se ai është Mehdiu, që nuk di të pushojë ose të kthejë fjalë, kur ndonjë shok a shoqe i kërkon ndihmë për çkuljen e kërçepëve.

### Komandantja e kompanisë

Atje, midis shoqeve të tërheq vëmëndjen një vajzë shumë e shkathët, me flokë të lëshuara e pak esmere. Që në të parë mendon se ajo është e kalitur në aksione. Dhe mendimi s'të lind së koti. Ajo ka qënë në marshimin e gjatë me inkursio-

nistët e Brigadës së parë sulmuese dhe gjatë rrugës pa vetëm një pjesë të maleve të Skraparit. Marshimi i dha forca të reja, e mbushi me frymëzim dhe e miqësoi me këto male.

— Rinia dhe malet duhet të jenë gjithmonë miq. Ne zgjodhëm malet e Skraparit, sepse edhe të rinjtë e të rejat e tjerë donin të njiheshin me egërsinë, freskinë dhe bukurinë e këtyre maleve — më shpjegon ajo.

Tek sheh vrullin e tyre mendon se të gjithë këta vullnetarë janë të gatshëm të shkojnë në të gjitha cepat e atdheut tonë të dashur e t'i bëjnë dhe malet e kodrat si fushat, ashtu si i porositi shoku Enver nga tribuna e Kongresit të 5-të të Partisë.

Unë i pashë myzeqaret e reja. Ato thua se të gjitha ishin të tilla.

### Dy të fejuar vullnetarë

Në kompaninë e parë u njohëm me Shpëtimin dhe të fejuarën e tij Shpresën. Që të dy qenë të parët që shprehën dëshirën për të shkuar në aksion. Ata të dy punojnë bashkë. Këtu dallon ndërgjegjen e pastër, e stilin e ri në punë. Me frymën e re, që janë edukuar e edukohen, ata do të krijojnë kondita të mira jetese në familjen e tyre të ardhme dhe në shoqëri.

Shumë prej tyre, të fejuar, deshën të vinin së bashku, por vetëm këta patën fat t'i shikojnë këto male.

— Këtu në mal ne shkojmë shumë mirë me shokët e shoqet tona. Kur të vemi në fabrikë do të

fillojmë punën me një vrull më të madh se, kur lëviz nga vëndi, e ndjen edhe më shumë përgjegjësinë e dashurinë për punën që ke patur, na tha Shpresa.

### **Ku luftoi kushuriri, punon ajo**

Matanë Qafës së Shkozës, 24 vjet më parë vërshëllenin plumbat: luftonin partizanët me armiqtë e vendit. Në ato kohra këndohej një këngë, që ngritën skraparllinjtë, kur luftonin kundër hordhive të huaja:

*N'ato kodra mbi Spatharë*

*Lëftonin ca partizanë...*

Bashkë me ta, në vendin ku u formua Brigada e 16-të sulmuese, ishte edhe kushuriri i Fatbardhës, që luftoi si shumë myzeqarë dhe ra me lavdi në fushën e betejës.

Sot atje punon brezi i ri i Myzeqesë për të hapur toka të reja. Atje punon dhe e kushurira e myzeqarit të rënë, Fatbardha, që i është qepur pllajës e s'do të epet nga vështirësitë. Vullnetarët disa vargje të një kënge të luftës i kishin zëvendësuar me vargjet e reja të punës. Dhe ngjante sikur në këtë këngë ishin shprehur çaste të luftës dhe të punës:

*N'ato kodra mbi Spatharë*

*Po punojn' ca vullnetarë*

*Porsi ari derdhet dheri*

*Rroftë Partia dhe Enveri!*

Në male ata kaliten. Ata do t'u thonë myzeqa-rëve, se në atë vend aq malor e me plot vështirësi, sigurohet buka për gjithë vitin. Ja, Fatbardha sot ka realizuar normën 120 përqind.

• • •

Rruga që të çon nga Therepeli në Qafën e Shkozës, ku punojnë vullnetarët, të kujton të kaluarën kur shikon dy lapidarë të ndritur në ato kodra. Njëri u kushtohet Brigadës së 16-të sulmuese, kurse tjetri dëshmorit Gani Nivica. Në këtë vend mbli-dhen të gjithë dhe shikojnë gurin që kanë çpuar plumbat. Aty, kryetari i kooperativës së Therepelit bëri një takim me ta dhe u foli gjatë për luftrat e përgjakëshme që janë zhvilluar atje si dhe për jetën e dëshmorit gjatë luftës.

Të rinjtë mbajtën shënime dhe disa pasuruan ditaret që kishin mbajtur në aksion.

### Diallogu nisi me guzhiniere

Thonë, disa, se vajzat, që merren me aktivitete e shkolla të ndryshme, nuk dinë nga punët e shtë-pisë e guzhinës. Po ne shkuam atje në kodër, ku hanin bukë vullnetarët dhe midis nesh lindi ky diallog:

— Guzhiniere jeni ju?

— Po, guzhiniere.

Ajo s'ka qënë më parë guzhiniere, po ja që rasti e pruri.

— Si e muarët këtë punë, pa e ushtruar mirë profesionin?

— S'ka gjë për t'u çuditur, lindi nevoja.

— Po shoqet dinë?

— Po mësojnë si unë. Koha kërkon të jesh jo vetëm bujkeshë, por edhe luftëtare, edhe punëtore në fabrikë, edhe guzhiniere.

— Pse nuk punoni atje me kazmë? — e ngacmoj unë, sërishmi.

— Ku ta gjej atë të mirë. Më dërguan këtu me zor, duke më thënë se duhet të jetë një vajzë, asnjë prej nesh s'deshi, por më vonë e kuptova se dhe kjo ishte një punë që duhej bërë.

— Po, ju banoni këtu, apo shkoni me shoqet në Therepel?

— Jo, unë shkoj me to, s'dua të ndahem prej tyre, megjithse familja e kësaj shtëpie më luten të rri këtu. Janë shumë mikpritës.

Pranë është Violeta dhe na ndërpret:

— Po ju tregoj një rast për plakën e shtëpisë, ku fle unë me një shoqe tjetër. U ktheva nga puna e po lexoja gazetën pranë vatrës, ku nëna kishte vënë në zjarr bukën për të pjekur. Pas dhjetë minutash e hoqi nga zjarri dhe na e dha neve me që ajo ishte e ngrohtë dhe na kish marrë uria nga puna e rruga e largët. Ne nuk deshëm ta merrnim se nuk ishte koha e bukës, por nëna nuk e kthente. Të them të drejtën gjithë atë natë kam qënë e pushuar nga një ndjenjë gëzimi. Amvisa e shtëpisë silllej si nëna e jonë. Ne mësuam prej saj, prej shpirtit dhe sjelljes së saj.

## Aksioni të frymëzon

Pas kthimit nga puna, u mblodhëm në qendër të fshatit dhe biseduam për punën e tyre, aktivitetet etj. Bri nesh, mbështetur në trungun e një peme një djalosh zeshkan, kishte hapur bllokun e shkruante. Ai thurte një vjershë. Nuk prish shumë punë në qoftë se vargjet nuk janë të goditura artistikisht:

*...Pranë vatrës ne ishim tre:  
Dy shokë dhe plaku i shtëpisë.  
Filluam e bisedonim ne  
Për ndryshimet e Shqipërisë...*

— Po të isha në Lushnjë, as që kisha për ta bërë këtë vjershë, thotë Andoni.

Jolanda në ditarin e saj ka shkruar:

«E shtunë, 17 dhjetor 66.

Të gjithë shkojmë në punë. Jemi të ndarë në dy kompani me nga tre skuadra seicila. Caktohen vendet e punës, e cila vazhdon me ritme të shpejta e brohoritje, për t'i dalë kodrës në krye.

Ta pushtojmë kodrën! Trungjet e mëdhenj nxirren njëri pas tjetrit e rrokullisen poshtë. Kur shikojmë flamurin në krye nxitemi për të punuar më shumë. Isufi duke rrokullisur gurët vret pak këmbën. E mjekojmë dhe i themi të pushojë, por ai s'pranon, s'do të mposhtet nga vështirësitë. Edhe lumturia ka raport mjekësor, por më shumë punon dhe, duke çaluar nga këmba, ajo bën një orë rrugë, deri në vëndin e punës.

Puna që kryejmë është e lodhëshme, por e bukur. Sa dëshirë kemi të qëndrojmë pranë këtyre njerëzve mikpritës!...».

## FLAMUJT E KUQ VALËVITEN MBI BICKË

220 të rinj e të reja hapën hektarët e parë  
të tokës së re

Pranë majës së Bickës janë 220 vullnetarë. Rreth tyre maja të larta e më përtej kanë ngritur kryet e thinjura me dëborë maja të tjera, si ajo e Ostrovicës, Gorës. Më larg, ajo e Lenies, Mali i Thatë e të tjerë viganë të moçëm. Moçi këndeji ka hedhur dëborën e parë, kurse rinia ka ndezur zjarrin e pashuar dhe ka shkelur përmbi acarin duke ngritur lart flamurin e vet.

**Bashkoi shokë me ne në çetë...**

120 të rinj e 60 të reja nga Vashtëmia marshonin përpara drejt Bickës duke kënduar këngën: «Bashkoi shokë me ne në çetë!». Dhe pas kësaj një këngë tjetër partizane, të cilën e kanë ndryshuar fare pak e i kanë dhënë një përmbajtje të re:

*Hajt t'punojmë  
Djersën ta kullojmë  
Se ndërtojmë  
Sot Bickën e re...*



Ndërsa këta këndonin dhe i ngjiteshin përpjetë Bickës, në Vashtëmi çdo gjë dukej e heshtur. Të rinjtë u ngjitën lart në male.

— Ku është Bicka? — pyesin më shumë se të tjerët Hilmia, Pashakua dhe Fiqiria.

### Jo, këtu s'jemi në Vashtëmi

Në gazetë u njoftua se 150 të rinj dhe të reja u nisën për në Bickë, se janë organizuar në 3 brigada. Po lajmi nuk është i plotë. Nuk janë 150, por 180 dhe jo tri, por katër brigada. E ky i dashur lexues nuk është faji i gazetës por i atyre djemve dhe vajzave të Vashtëmisë që nga dita në ditë shtonin radhët e tyre. Bile me ta u bashkuan dhe nja dhjetë të tjerë të moshuar, të cilët donin të punonin në mal sëbashku me rininë.

Atë mbrëmje rreth vatrave mikpritëse të fshatit Bickë të gjithë njerëzit kuvëndonin. Asnjëherë s'kish ndodhur një gjë e tillë, kaq e madhe, me përjashtim të netëve kur kalonin këtej brigadat partizane.

— Këtu s'jemi në Vashtëmi, tokë pa rrënjë e gjemb. Këtu i thonë Bickë, 6 muaj borë! Ja shikoni si e ka zbardhur.

Ata të Vashtëmisë mendohen t'i përgjigjen, por ja që del një i ri nga Bicka e thotë:

— Ne në shkurt i hapëm 4 hektarë. Thyenim akullin, pastronim dhe borën 80 cm. të trashë, morëm 100 kv...

— Si? Ju thyet akullin, pastruat edhe 80 cm. borë? Po ne mburremi se në kooperativën tonë hoqëm 40, cm. Shiko! Po akulli rrëshqiste?

— Po, rrëshqiste, e toka ish e ngrohtë nën shtresën e akullit.

### Dita e parë e punës

Dita 22 nëndor, vigjila e 25 vjetorit të Rinisë Komuniste, është dita e parë e punës. Dielli shkëlqen për bukuri dhe dëbora e parë në malin e Bickës shkrin, por qëndron diku e fshehur nën sqetullën e malit, si një kërcënim i theksur.

Pas pesë orë rruge nëpër kodra e male, jemi pranë pararojës së rinisë. Tani shohim hektarin e parë në vargun e 20 hektarëve tek hapet me kazma e bela. Këtu do të mbillet grurë, mollë.

Ata janë 180 nga Vashtëmia e 40 nga Bicka. Seicili ka jetën e tij, biografinë e tij. Xha Bajrami ishte i pari në rreshtin pambarim të të rinjve e të rejave. Ai është 60 vjeç, burrë i thinjur, si mali. Behxheti, bujk i mirë, ka ardhur bashkë me të birin, Bardhysin e nipin Ramadanin. Ata s'janë të një moshe, por kanë një zemër, një shpirt, një ideal. Ndodhem pranë dy shoqeve të ngushta, Xhevrihes dhe Afërditës. Ato janë zotuar dhe po bëjnë nga 35 metra katrore secila. Më tej dy vajza të tjera. Janë fare të reja, Fatimja e Nazimja 15 vjeçare, sa janë pranuar në BRPSH dhe kanë ardhur për të vënë në jetë fjalën që i dhanë organizatës se janë gadi të shkojnë ku ta dojë interesi i lartë i atdheut. Shoh Mitatin, Ritvanin e Zenelin. Kanë qethur kokat se shkojnë ushtarë. Të çuditshëm këta të rinj. Së shpejti largohen nga fshati e s'duan të qëndrojnë pranë familjeve të çmallen, siç është zakoni. Dëshën të mos i merrnin në rrugën e malit,

por si mund t'i ndaloje ata? Kanë vendosur të largohen nga aksioni vetëm një natë para se të nisen në ushtri.

Janë këtu, midis të rinjsh, Samiu, ish partizan i Brigadës së katërt sulmuese, ish vullnetarët e hekurudhës Ismaili, Demiri, vëllezërit Xhemali e Bajrami dhe Guraliu, tani brigadier në kooperativë. Ja edhe Hilmi, Pashakua dhe Fiqiria, tri shoqe që kanë normë kolektive. Kanë kaluar vetëm 3 orë dhe ato kanë hapur 48 metra katrore tokë të re, me thellësi 40 cm...

Këtu takohen brezat. Ata kanë ardhur të mposhtin malin.

## THEMELIN DJERSË, KULMIN BUKË

Mbi gjithçka të bukur që kanë të rinjtë janë duart, duart ku shpirti gërshetohet me moshën e vrullëshme, ku shpirti mbështetet për të treguar forcën dhe vullnetin, entuziazmin dhe guximin. Gjithkund dimri erdhi i egër, i ftohtë, por ndezi në zemrat e rinisë zjarr...

Mali, çerdhja partizane, mali, të cilit do t'i bëjmë një çerdhe tjetër me themel djersën e me kulm bukën, u ndez nga zjarret e rinisë. Në mes dëborës që zbardhëllon, në malet e veriut, shoqëruar me fishkëllimën e erës dhe me lëvizjet ritmike të kazmave e lopatave, të tezgave dhe gurëve, erdhën e punojnë të rinjtë fusharakë për të mposhtur shkëmbinjtë.

— Do të buçasin traktorët ndër male. Me kazma e lopata ne do t'u hapim rrugën traktorëve, — thanë të rinjtë.

— Mirëupafshim nëna dhe baballarë, motra dhe vëllezër, miq dhe shokë!

Behija kujton motrën e saj të vogël, ato nuk janë ndarë kurrë nga aktivitetet dhe aksionet e rinisë. Maturën e morën bashkë në shkollën e mbrëmjes, bashkë punuan në fushë, bashkë shpallën gara dhe u hëngrën për garat me drapër e lopatë, me tezgë e torogan, por gjithnjë me buzë në gaz, kurse tashti motra është në universitet.

Larg, por prapë shumë afër. Adresa e Behijes për një muaj rresht nuk është në Dobraq, por në Reç dhe letrat e motrës janë më të gjata, më të dashura. Nuk e dinë as dy motrat si ndodhi, por ato filluan t'i shkruajnë njera tjetrës sikur të dyja të ishin në aksion. Ja çka i shkruan Behija:

«Sot ka rënë dëborë e dendur. Mali Beterat ku ne punojmë është zbardhur, por puna vazhdon. Balli i Safetes është mbuluar me bula të mëdha djerse. Unë me Felekun qeshim.

— Çka ke bre Safete?

— Plasa të nxehtit!

— Bravo rini, djersa jote rreze dielli, e shkrika dëborën, flet Rakipi.

Ti e di se unë jam pak e mbyllur në vetvehte, por sot besoj se kam luajtur me topa bore tamam si fëmijë. Ishte pushim dhe dy 16 vjeçarët tona Vera dhe Feleku filluan të luajnë. Ishin skuqur në fytyrë dhe vraponin. Gëzimi i tyre na përfshiu dhe neve, por çanga për fillimin e punës na gjeti në taracat. Sot në radhët tona u bashkuan edhe njëzet fshatarë. Në ditët e këqia këtu nuk ka ditë pune, por një prej tyre na tha: «Ju keni ardhur prej Dobraqi dhe po punoni për ne, e jo më ne që duhet të punojmë edhe nëpër terr». Kjo na kënaqi mbi gjithçka e dashur motër. Ti mëso mirë që në provimet e janarit të ndahesh shkëlqyeshëm, se ne na e vuri notën shumë mirë ai fshatari i aksionit. Mirëupafshim!»

Këta të rinj për gjithçka thonë mbjellim e korrin. Gjithçka ua dedikojmë duarve dhe mëndjes. Kur së pari erdhën në Reç ata filluan, të zgjojnë çangën me këngët e tyre të bukura e të forta dhe fshatarët ka afro një muaj që nuk e masin fillimin

e ditës së punës me çangën, por me këngën e vullnetarëve.

Bie çanga. Çudi na e paskemi pastruar një pjesë të mirë të malit nga dëbora. Nga toka e porsa çelur qilizëm buron nxehtësi. Me kazma ndër duar ne drejtohem për në shtëpinë tonë. Atje një nënë nga Reçi na ka pregatitur drekën. Feleku mban flamurin.

### U pranua në rini

Felekja u pranua anëtare e BRPSH-së në Reç. Ja çfarë kujtimi i bukur do të lidhet për të me ditët e aksionit. Tesera e kuqe do t'i kujtojë ditën e nisjes në aksion, kur gati i shpëtuan lotët kur u nda nga familja. Vullnetarët bënë një marshim nga lapidari i dëshmorëve të Reçit e deri në Vajush. Ishte ditë e vrejtur dhe binte shi, por kep më kep ushtoi kënga e partizanëve të rinj të malit. Në shi e të ftohët ajo e djelë u kthye në një marshim të zjarrtë. Askush s'e ndjeu lodhjen. Rakipi, pjesëmarrës në marshimin e gjatë në gjurmët e Brigadës së I-rë sulmuese tregon, se si njëri nga të 4 shokët e tij të shëndoshë e mbajtën në krah. Rakipi u thotë shokëve e shoqeve:

— Mos më qeshni, por mua më dukej se një shok 'i imi i luftës ishte plagosur, detyra ime si luftëtar dhe i ri ishte ta tërhiqja shokun tim në krah, që ai të shihte se si në betejat tona korrin suksese.

Behija tregon për eskursionin:

— Ecnim me hap ushtarak dhe këndonim. Mbi supe mbanim kazmat dhe në zemër gëzimin tonë.

Gëzimi ishte e vetmja gjë që i komunikoni njëri tjetrit, me këngën, me fjalët, me sytë, me hapin tonë ushtarak, me lopatën si me pushkën. Kur u kthyem ishte duke u errur. Tek lapidari na priste i gjithë fshati dhe ne dhamë për ta një program artistik. Ishim shndërruar që të gjithë në këngëtarë të mirë, në agjitorë të flaktë. Mbas programit dhe bisedave Safetja, sekretarja e rinisë, shpërndau 4 taserat e rinisë.

Felekja tha: «Babai im kur ishte 16 vjeç erdhi partizan në Reç dhe këtu mori pagëzimin si i ri komunist, kurse unë erdha si partizane e partisë për hapjen e tokave të reja dhe e kam tejkuluar normën çdo ditë. Kjo taserë do më kujtojë ditët e bukura të aksionit dhe gjithnjë do të jem krenare për taserën e kuqe».

Katër antarët e rinj puthën flamurin, të cilin brigada e tyre, e ka mbajtur lart çdo ditë.

Safetja përfundoi:

— I riu më i fortë se shkëmbi; ne çvendosim shkëmbinjtë për të ngritur një godinë të re, me themel djersën e me kulm bukën.

## RINIA E FSHATIT DREJT MALIT

(Ditari i një të riu)

Atë ditë nuk isha në fshat. Lajmin e mora në ambrëmje.

— Tërë rinia e fshatit, — më tha kryetari i kooperativës vendosi nesër të hidhet në aksionin e saj, një mujor, për çeljen e tokave të reja.

Rinia do t'i rrëmbejë pëllëmbë për pëllëmbë tokat e malit, për t'i bërë ato pjellore, tokë buke.

### Drejt malit

E premte, 30 dhjetor 1966!

Në orët e para të mëngjezit në rrugët e fshatit kishte lëvizje të madhe, kollona e vullnetarëve do t'i ngjitej malit përjetë.

Ne lamë mbrapa fshatin dhe me këngë në gojë arritëm tek «Çuka e vogël», ku do të punojmë 1 muaj. Ne e pamë mirë vendin tonë të punës.

Përpara, si një re e bardhë dhe hije rëndë, qëndron Tomorri, ndërsa mbrapa shquhej një hapësirë e thellë, e pafund.

Një shtresë e hollë dëbore kish mbuluar tokën, për rreth. Rrezet e diellit mëngjezor rrëshqis-



nin pllajave. Sa e fuqishme tingëllon këtu kënga «Bashkohu shok me ne në çetë».

Një tufë fëllënxa, të trembura nga vullnetarët, çanë ajrin me një shpejtësi të rrufeshme.

### Një vajzë ulet nga shpati

Në këtë kohë, në faqen e malit, pamë të vinte drejt nesh një vajzë. Ishte Resmija.

Ajo na përshëndeti si me gjysëm zëri.

— Ku ishe kështu, o Rezmie? — pyeti Petriti.

— Më falni në gabova, — u përgjegj ajo duke ulur kokën, — si t'ju them... Por, kur dëgjova këngët e brohoritjet tuaja, s'desha të mbes veç shokëve. Lashë punën që kisha nisur, dhe me një frymë, si më shikoni, erdha midis jush.

— Shumë mirë ke bërë, të lumtë, që erdhe, por këtë mos e përsërit herë të tjera. Delen e shkëputur e ha ujku.

### Puna filloi

Në fillim u bë inkuadrimi. Formuam një kompani prej 65 të rinjsh, të ndarë në katër skuadra. Atë ditë, sëbashku me ne kishin ardhur kryetari i kooperativës, sekretari i partisë dhe kryetari i këshillit popullor të fshatit. Për të përshëndetur të rinjtë fjalën e mori kryetari i këshillit popullor, Qemali. Ai tha:

— Ju nuk e njihni kohën e kaluar. Që të hapje një copë tokë duhej të bëhej një varr, se tjetri nuk të linte, por sot jeta ka ndryshuar rrënjësisht...

Ju uroj punë të mbarë dhe krahë të palodhur.

Puna filloi. Toka u drodh nga të goditurat e kazmave. Ambienti është i vështirë, por dhe të rinjtë janë të vendosur. Prej krahëve të të rinjve, dilte toka, një tokë e zezë e plot humus dhe, bashkë me të, gurë, shkurre dhe rrënjë.

### Komisari dhe ne

Në pushim u grumbulluam në një vend pa bar, ku s'na rrihte era.

Bajrami, komisar i ynë, tha:

— Sot, — do të lexojmë një pjesë nga kapitulli i katërt i raportit të shokut Enver.

Ne të gjithë e ndjejmë vehten të rinj revolucionarë, që në të njëjtën kohë punojmë dhe edukohemi me mësimet e partisë. Çdo i ri apo e re ndjen përgjegjësinë e detyrës së tij, ashtu si porosit partia.

Mbas leximit, filluam diskutimet rreth problemeve që ngre raporti e pastaj u hodhëm në sulm me forca dhe energji të reja.

### Përbuzin vështirësitë

Ora 14. Deri tani janë hapur 1300 m<sup>2</sup> tokë e re. Vrulli i punës sa vjen e shtohet. Kur i shikon shokët ashtu duke u përleshur me vështirësitë e hasura nuk ke mundësi që të dallosh, më se kush është për t'u cilësuar si i dalluar.

Të shkruash për Myrtezanë apo për Fatmirin, për Xhaferrin apo për Diturinë, për Ryfedin apo për Hasanin ke frikë se ke harruar të tjerë që janë të palodhur.

— Qysh ditën, e parë u pa i qartë vrulli dhe hovi i të rinjve. Ata në qilizëm e realizuan normën 110 përqind.

Kur errësira e purpurtë ra, mbi kodrën ne u drejtuam për në fshat.

Të armatosur me idetë dhe vendimet e mëdha të kongresit, të rinjtë e Borgullasit, përbuzën të ftohtin e dimrit, terrenin e vështirë dhe lodhjet, vetëm e vetëm që fshatit t'i japin sa më shumë tokë buke, ta bëjnë atë, më të lulëzuar.

## RINIA E PIRGUT SULMON LARTËSITË E FSHATIT

Dritat e sallës nuk po shuheshin edhe pse po afronte mezi i natës. Familjet prisnin bijtë e bijat të ktheheshin në shtëpi. Vonesa e tyre tregonte se rinia ishte kapur pas një problemi tepër të rëndësishëm dhe po diskutonte. Nuk kishte pak ditë që të rinjtë e kooperativës fushore të Vashtëmisë, duke vënë në jetë mësimet e detyrat që shtroi Partia në Kongresin e saj të pestë, u nisën drejt malit të Bickës për të hapur toka të reja. Kjo inisiativë diskutohej atë natë në kooperativën e Pirgut. Sipër fshatit fillonin bregoret, kodrat, malet. Sytë duheshin kthyer edhe drejt lartësive. Rrugët që çonin në fushë tashmë ishin hapur. Atje shkonin traktorët, maqinat mbjellëse, korrëse e shirëse. Duheshin shtigje të reja, Duhej hedhur kazma në sup dhe me të të ngjitesh gjithmonë lart e më lart për të çpyllëzuar, për të thyer shkëmbinj e gurë dhe për të hapur tokë buke.

Dhe në çastin kur të rinjtë e të rejat diskutonin mbi gadishmërinë, mjetet e punës dhe frontet e punës, ngrihet Shefqeti dhe thotë:

— Propozoj që sipërfaqen e tokës së re të planifikuar për të hapur gjatë këtij pesvjeçari, ta rrisim edhe 7 hektarë...

Çdo gjë u diskutua, u studjua dhe u vendos. Të

nesërmen komitetit të rinisë të kooperativës së bashkuar i vjen edhe një zotim tjetër nga grup organizata e sektorit të Zvirinës. Ata kishin vendosur dhe zotoheshin që sipërfaqja e tokës së re të hapej për dy vjet. Ky zotim u përkrah nga të gjithë të rinjtë dhe të rejat dhe kaluan menjëherë në vepra.

Një mëngjez me erë, shi e të ftohtë, ashtu si janë mëngjezet në fushën e Korçës, veshur gjate gjithë dimrit me çarçafin e bardhë të dëborës, 300 të rinj e të reja u rrjeshtuan në sheshin qëndror të kooperativës. Ishin ndarë në kompani. Midis tyre, me kazma në duar ishin rrjeshtuar të rinjtë pararojë të kooperativës: Shefqeti, Nurka Manushaqja, Safeti, Fatbardha, Virgjinushi, Vasilika, Margarita, Nazmiu dhe të tjerë. Në krye të kompanisë së parë qëndronte i shtrënguar në radhët e rinisë edhe Njaziu, i cili me thirrjen e partisë e të qeverisë është kthyer në fshatin e tij. Gjithashtu në radhët e të rinjve ishte rrjeshtuar edhe agronomi i kooperativës. Ay do të shkojë sëbashku me ta për të ndihmuar të rinjtë në hapjen e tokave të reja, jo vetëm duke i udhëzuar, por edhe duke punuar krah për krah tyre.

Komandantët e kompanive paraqesin forcën:

— Shoku komandant i shtabit të aksionit: 80 të rinjtë e të rejat e kompanisë së parë janë gati për të sulmuar kodrat e malet. Pastaj shpërthente një urra e fortë. Qindra kooperativistë burra, gra, pleq, plaka dhe gjithë nxënësit e shkollës ishin në këtë ceremoni solemne. Shiu që vazhdonte të binte i jepte madhështi e forcë asaj atmosfere revolucionare.

— Përpara shokë, drejt maleve! — thirrën njëzëri dhe u nisën...

Puna kishte disa orë që kishte filluar. Ishin kazmat e para që çkulnin drurët e shkurret, që thërmonin shkëmbinjtë e malit të Kozelit. Fusha poshtë kishte hedhur supeve një tyl gri dhe kanalet e vijat që ndanin parcelat, i jepnin asaj një bukuri të rrallë.

Në pushimin e parë të këtij aksioni, në mes të rrëkeve të ujit që kullonin nga faqja e malit, ata ja morën një kënge. Ishte kënga e punës. Kjo këngë ishte vazhdim i asaj që kënduan partizanët njëzet e ca vjet më parë, kur me pushkë në dorë qëllonin në lule të ballit armikun. Pastaj të rinjtë e të rejat bënë një takim pesë minutësh. Në këtë takim u vendos që toka që po hapej të mbulej me patate. Ne mbrëmje normisti mati sipërfaqen e tokës së re. Ay shënoi në krye të bllokut të tij shifrën 1.3 hektarë..

Të nesërmen lista e të treqindve u shtua. Shtabi i aksionit vendosi të hapë edhe dy fronte të tjera: Një në malin e Arunit dhe tjetrin në Krastën shkëmbore të Veliternës.

Puna filloi. Shiu vazhdonte të binte dhe s'kish të pushuar. Grupi i Krastës punonte në terren shumë të vështirë. Të rinjtë shpesh herë duhej të përdornin qysqinë e varenë për të thyer shkëmbinjtë. Taracat e para, radhë-radhë, i ndrruan pamjen shekullore malit. Pas disa ditësh të rinjtë e të rejat e këtij sektori bënë një mbledhje. Aty ata vendosën që taracat t'i mbjellin drithra. Plehrimin do ta bëjnë me torfë që do ta sjellin një orë larg. Sipas llogarive të para, ata menduan që për gjithë sipërfaqen që do të hapin në këtë mal, rreth 8 ha, të sjellin 4000 kv. torfë.

Edhe në malin e Arunit grupi i të rinjve filloi punën me vrull. Në vitin 1964, në rrëzë të këtij

mali, ishin hapur disa vetullore, po kufiri i tyre drejt malit nuk ishte shtyrë më lart, mbasi fillonin shkëmbinjtë. Tashti të rinjtë hodhën kazmat e qysqitë mbi tokën shkëmbore dhe nga dita në ditë po ngjiten lart e më lart. Mbi 1200 vetullore zbukurojnë shpatin e malit. Ato do të shtohen edhe më shumë nga puna që bëhet çdo ditë.

Plani i të rinjve ishte i qartë. Ata sipas fjalës së dhënë, e hapën gjysmën e sipërfaqes që patën marrë zotim. Fondit të tokës së kooperativës duke punuar me forcat e tyre, i shtuan edhe 31 hektarë.

Të rinjtë dhe të rejat, krahas punës për hapjen e tokave të reja në kodrat e malet që përfshin kooperativa e tyre, kanë bërë edhe planet për ujitjen. Në tokat që po hapin në malin e Kozelit, ata do të ndërtojnë një rezervuar, në të cilin do të mblidhen ujrat e burimeve që dalin nga mali dhe me të do të vadisin kulturat që do të mbjellin çdo vit në tokat që po hapin. Edhe vetullore mbi malin e Arunit do t'i vadisin me ujët e Gurëzës, i cili do të vijë me anën e një kanali 1000 metra të gjatë, që kalon nëpër një terren të vështirë dhe pjesë-pjesë tokë shkëmbore.

Në të gjithë sektorët këto ditë ka pasur dëborë dhe temperatura ka qënë disa gradë nën zero. Puna megjithatë vazhdon. Hapet dëbora (ajo në malin e Kozelit arrin në një gjysëm metri), çpyllëzohet vëndi, hiqen shkëmbinjtë dhe bëhet sistemimi.

Sipërfaqja e tokës në kodra e male shtohet çdo ditë. Të rinjtë e kooperativës së bashkuar të Pîrgut në rrethin e Korçës, po vënë në jetë një detyrë që shtroi Kongresi i 5-të i Partisë: e kanë kthyer shikimin edhe drejt kodrave e maleve dhe po i kthejnë ato në toka për bukë, patate e pemë frutore.

## **VRULLI YT RINI, DO T'I BËJË MALET FUSHA!**

E djela e datës 15 janar që për Fierin një ditë feste dhe e manifestimit të shpirtit revolucionar të rinisë myzeqare, e gadishmërisë së saj për të zbatuar thirrjen e shokut Enver për t'iu qepur kodrave e maleve e për t'i bërë pjellore si dhe fushat. 750 vullnetarë zbrisnin nga Mallakastra partizane, 900 ngjiteshin për në Mallakastër. Ata që ktheheshin thërrisnin Enver-Parti-jemi gati përsëri. Ata që ngjiteshin buçisnin Enver-Parti jemi gati ku do ti! E sheshi «Stalin» ushtonte nga brohoritjet e qindra vullnetarëve.

Filluan të ngjiten në makina. Duken vegla pune e fizarmonika, strajca me sende personale dhe pako me libra e revista. Jepet komanda dhe autokollona me 34 maqina niset. Në krye janë ata të Frakullës së Madhe, që nisen për në Çorush. Kjo organizatë ka dërguar më shumë të reja, se sa kooperativa «Skënderbej». Ja dhe dy maqina që nisen për në Kutë. Një djalosh i bie klarinetës bukur, shoku i tij e shoqëron me fizarmonikë.

### **Në fshatin e dy heronjve**

5 kamionë, duke u lëkundur si të dehur në rrugët malore, lanë Ballshin dhe u ngjiten në të përpjetën e Kashit, shkojnë në Hekal, emër që na



kujton dy heronj të popullit tonë, të cilët ndonse i ndajnë shekuj, lidhen e afrohen me njëri tjetrin nga emri i fshatit, ku u lindën dhe u rritën të përkundur në djepin e heroizmave popullore.

197 vullnetarë zbresin te sheshi i fshatit.

Hekali i priti me flamurë, me këngë e gëzim. Këta ishin miq të jashtëzakonshëm. Sot ka ardhur fusha t'i japë dorën malit e të çajné sëbashku dje-rrinat, të ngrejné mure, të sheshojné brigjet, ku kanë shkelur Rrapo Hekali legjendar dhe komunisti hero Dervishi. Këta kanë ardhur të vazhdojnë këngën e të rinjve të Lapardhasë të cilët në malet e Terpanit kënduan:

**Thirrjes që bëri Partia**  
**Ju përgjegji e gjithë rinia!**  
**Fjala e shokut Enver**  
**Porsi lulja në pranverë!**

Ndërsa mbi Mallakastër fryn veriu që të than, sikur do t'i trembë e t'i largojë këto vajza të reja e këta djem të rinj. Po ata janë vullnetarë, e vullnetarët nuk lëvizin se kanë ardhur «malet t'i bëjnë fusha, të korrin drithra të shumta».

### **Skuadra e rinisë hodhi e para kazmën**

Mëngjezi që i pastër dhe i ftohtë. Vullnetarët u vonuan jo se mbrëmë fjetën vonë, por nuk i linin nënat, zonjat e shtëpisë.

— Pritni moj koce! Akoma s'ka zbardhur. Ku do vini? Hani bukë pa shkoni.

— Jo moj nëno, u bë vonë. Na presin...

— Asnjë s'ka dalë. Hani bukë ngadalë.

Nga pragjet e shtëpive, të shoqëruara me vajzat e Hekalit, dilnin të rejat fusharake, të mbushnin mushkритë me erën e malit dhe i gëzoheshin ditës së re...

Në sfondin e blertë të ullinjve u dukën vullnetarët e Qarrit, Ndërnenasit, Pojanit dhe të Cakra-nit, me flamurë të kuq. 197 vullnetarë nisën këngën e punës.

Të parët hodhën kazmat në tokën për të hapur qilizmë, vullnetarët e kompanisë së pestë. Para tyre prisnin gjambat dy djem nga fshati. Në doni të dini se kush nguli kazmën e parë, qe skuadra e Vitas.

— Hë moj Vita! Do t'i lulëzoni këto brigje.

Dhe Vita, një çupë 17 vjeçare, të përgjigjet me gaz:

— Posi, do t'i lulëzojmë.

— Me cilin jeni në garë?

— Me skuadrën e Zenunit. Po do t'ia kalojmë...

Pak më tutje është skuadra e dytë. Dhe ata e nisën punën menjëherë. Dëgjuan fjalët e Vitës dhe thanë:

— Po t'u lëmë ne... Ahere do ta merrni flammurin.

— Do ta shohim!

Komandanti i kompanisë, Tajari, më thotë se organizata e rinisë së Qarrit, ka 96 anëtarë të BRPSH-së, 38 veta u kthyen nga Drenova e Ballshit dje, dhe po kaq punojnë këtu. Kurse që të gjithë janë regjistruar për në hekurudhë. Por ata sot janë 39 vullnetarë, me ta punon dhe kryetari i kooperativës së tyre, shoku Kamber.

Lamë kompaninë e pestë dhe u ngjitëm pak

më lart, te kompania e dytë që e drejton Asllani. Asllani është djaloshtatgjatë e i hedhur.

— O burrani, o burrani! thotë ai. Po na e kalojnë ata të Qarrit. E shikoni, po vazhduam kështu do të ngjiten te këmbët tona.

Thirrja e tij dëgjohej nga vullnetarët, të cilët lëvizin më shpejt duart. Secili do të fitojë flamurin.

Është ftohtë, era e veriut të than, por rinia nuk don t'ia dijë, ajo sulmon. Bregu i Tolajt dridhet nga 100 kazmat e rinisë.

### Duke shkelur mbi akull!

Megjithse ora vajti 12, akulli s'ka shkrirë. Kudo akull, e megjithse ka diell, era e ftohtë nuk e lë të shkrijë. Si kalon disa përrenj të vegjël, ngjitesh në Barush. Në këtë vend punonin dhe shumë vendas. Të kënaqet syri kur shikon se pranë kushërirave Arsino dhe Marie nga Baltëza e kooperativës «Bajram Curri», punon Kismetja nga Hekali. Që mbrëmë rreth vatrës bujare ato nisën miqësinë. Në shtëpinë e Kismetes erdhën Arsinoi shitëse buke në Baltëz dhe Maria, anëtare e brigadës së fushave. Dhe ja tani të trija. Ky copë vend është i vështirë, ka gjemba dhe rrënjë të thella, por ato nuk mërzhiten. Dhe pak e gjembat mbarojnë, thotë Arsinoi.

— Pa shikoi, më thotë Nevruzi, nënkryetari i kooperativës së Hekalit, pa shiko si i ka vënë përkrah të dy vullnetaret një vajzë e fshatit tonë?! E Nevruzi buzëqesh i gëzuar. Ne shkojmë akoma më larg, aty ku po digjen gëmushat e ferrat për t'i lënë vendin filizit të misrit apo grurit.

## MALET NUK FLENË NËN DËBORË

...Po, malet nuk flenë nën jorganin e dëborës, sepse ato i ka zgjuar herët në mëngjes rinia. Nuk ju ka hije të dergji nën jorgan të dashur babagjyshër-male! Është kohë pune! Disa vjet më parë kjo «sjellje» e rinisë me malet, edhe kur mbi kurrizët e tyre mbajnë dëborë, do të merrej si e çuditëshme. Kjo është poezi dhe më të fortë se kjo kur shikon në mes të maleve, dikur të përgjumura, të rinj që punojnë, që hapin tokë buke, që bëjnë çakëlle taracash, nuk ka. Malet në dimër nuk janë vetëm për t'i shkelur skiatorët e alpinistët; malet në dimër nuk janë vetëm për t'i soditur nga larg poetët lirikë; malet në dimër janë edhe sheshe të betejës së punës së rinisë. Në sheshe të tilla filluan të kthehen ata që kur dora e partisë shkroi radhët e para të Thirrjes e të Letrës së hapur; u zhvillua dhe u përhap akoma më me furi në tërë Shqipërinë, atëhere kur në Tiranë, nga tribuna e Kongresit të 5-të, shoku Enver Hoxha, udhëheqësi ynë i dashur, tha: «T'u qepemi kodrave dhe maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat». Dhe që t'i bësh «ato pjellore si edhe fushat» duhet të mos i lesh të flenë as verës, as dimrit.

Rinia jonë ka shpirt revolucionar. Malet ajo nuk i shikon vetëm si dëshmitare të betejave shekullore të popullit tonë, nuk i shikon vetëm si kë-

shtjella të pamposhtura, ku thyen kokën tiranë e sundimtarë, pushtues e tradhëtarë, por edhe si burim thesaresh. Dhe në këtë burim thesaresh nuk kërkohet vetëm minerali, por edhe drithi. Me forcën e saj dhe me mëndjen e saj të mprehtë, rinia jonë i di se ku t'i kërkojë këto thesare, ajo di t'u bëjë me shkathtësi gjokseve malorë radiografinë e të thotë: «Këtu e kanë thesarin!» Me të thënë këto fjalë ajo derdhet me kazmën e saj çudibërëse dhe malet fillojnë e gjëmojnë.

Është vështirë në ditët tona të marrësh në duar hartën e maleve e të zesh e të tregosh me majën e lapësit pikat ku është përhapur armata e të rinjve dhe të rejave revolucionarë me kazmë në dorë. Janë të panumurta këto pika. Atje janë grafikët e punës, atje janë zotimet, atje janë besimi dhe optimizmi.

Dhe ja më 21 janar 1967 ata vinin nga malet dhe binin në kryeqytet aromën e lartësive, erën e dheut të përzier me dëborë, shënjat e suferinës në fytyrat e tyre të burrëruara, shikimin e mprehtë të shqiponjave, hapin e guximshëm dhe të vendosur të atij që e ndjen veten më të pjekur, që ka hyrë me të dy këmbët në jetë.

Ata vinin nga malet dhe sillnin në rrugët e Tiranës gëzimin e fitores, ndjenjën e fortë të shoqërisë të lindur e të lidhur nëpër vështirësi, sillnin shëndetin, entuziazmin rinor, por më tepër besimin.

Ata vinin në Tiranë dhe ngjitnin shkallët e Pallatit të madh të kulturës pa drojtje, ashtu siç do të futeshin në çdo shtëpi fshatari, në çdo kullë malësori. Është rinia që do t'i ngjitet qiellit, rinia që ka filluar ngjitjen e saj, drejt majave, drejt lartësive.

Ata vinin nga malet, nga Terpani e nga Dhëmbeli, nga malet e Korçës e të Shkodrës, nga malësia e Tiranës dhe nga malet që ngrihen mbi ujrat e kalτέρα të detit Jon. Ata vinin nga malet në fusha, në kryeqytet.

Ishin 350 të rinj e të reja, një pjesë e vogël e armatës së të rinjve që ndodhet në male, lufton në male. Ata erdhën në Tiranë, ku kishin takimin e tyre.

Të rinjtë ngjiten në tribunë po aq të sigurtë e të qetë dhe flasin pa druajtje, me emocion, plot gjallëri e entuziazëm, ashtu siç flisnin e bisedonin me shokët në maja të maleve me kazmën në dorë, midis shkëmbinjve, dëborës e suferinës. Sa e kalit rininë lufta, përpjekja, sa shpejt e rrit ajo atë, sa ja forcon besimin në forcat e veta, sa ja rrit energjitë!

Këta që po flasin janë djemtë e vajzat e atdheut tonë. Ne i dëgjojmë dhe krenohemi, i dëgjojmë dhe kthejmë mendimin prapa, na kujtohen kohët e shkuarda, të rinj të një brezi tjetër, të cilët do të mbeten gjithnjë të rinj në kujtesën tonë. Edhe ata zbritnin nga malet, nga lufta, nga aksioni, me pushkë në krah, dhe kur takoheshin në një shkollë fshati, flisnin kështu pa druajtje, me guxim, me entuziazëm. Brezat janë të ndryshëm, mënyra e luftës nuk është po ajo, por rinia, zemra e saj, është e njëjtë. Ajo ka në gji të njëjtin zjarr, zjarrin që i ka ndezur partia, zjarrin që u kishte ndezur prindërve të saj kur edhe ata ishin të rinj, si bijtë e tyre sot.

Në tribunë ngjitet i pari një i ri beratas. Ai është nga Lapardhaja. Dhe kur thuhet «është nga Lapardhaja», kjo mjafton: këtu nuk do të duhej të përmëndej vetëm një emër, por 160, dhe lista do të ishte e gjatë. Ata ndëzën të parët shkëndijen që u

bë zjarr dhe muarën të parët atë rrugë në të cilën ecën gjer tani 15.000 të rinj të tjerë.

Të rinjtë flasin nga tribuna. Ne dëgjojmë episode, ngjarje; ne dëgjojmë sidomos entuziazmin e fitimtarëve që kthehen nga beteja, ne dëgjojmë vendosmërinë e luftëtarëve që duan të kthehen prapë në betejë, ta vazhdojnë atë nëpër kodrat e malet, për t'i shtrirë e rritur fushat e Atdheut, për të shpurë në shkrepat shekullore të maleve gjallërinë e punës, lulëzimin, begatinë, përparimin.

Malet tona kanë nevojë për rininë. Atje do të lulëzojë, bashkë me trëndelinën, dhe jeta e gjallë, plot punë. Në të ardhmen atje do të krijohen fshatra, qytete të reja. Malet kanë nevojë për rininë, por edhe rinia ka nevojë për malet. Atje ajo kalitet, bëhet më e pjekur, më revolucionare.

Një vepër e madhe, një ideal i lartë, kalit edhe njerëz me zemër të madhe, me ide të qarta, që dinë të pushtojnë në horizontin e tyre të gjerë mendor gjithë ç'është e mirë, e pastër, revolucionare, që dinë të ndjejnë thellë e t'u rrahë zëmra për fatet e popullit, të Atdheut, të socializmit, duke përbuzur egoizmin, jetën e ngushtë mikroborgjeze, rehatinë, mëndjemadhësinë.

Marshimi guximtar i rinisë sonë në këtë betejë të re e të madhe sapo ka filluar. Dhe rinia jonë do të eci përpara, e sigurtë, e vendosur, e guximëshme, ashtu si rinia jonë e djeshme, ashtu si prindët e saj. Dhe të rinjtë e këtij takimi, kur u ndanë u përshëndetën me fjalët:

— Mirupafshim prapë në malet e kodrat e Shqipërisë!

## **NGA TRIBUNA E TAKIMIT KOMBËTAR TË TË RINJVE QË SULMUAN KODRAT DHE MALET**

**«Ne u frymëzuam nga idealet e larta të partisë»**

Kështu e filloi fjalën e saj Behija, e re nga Dobraçi i Shkodrës që punoi në malet e kooperativës bujqësore të Reçit.

— Rinia e rrethit të Shkodrës iu përgjigj me vrull revolucionar thirrjes së shokut Enver për t'iu qepur kodrave e maleve. 2000 të rinj e të reja nga qendrat e punës e të prodhimit, morën zotim që deri në vitin 1970 të hapin seicili prej tyre nga një dynym tokë të re, domethënë gjithsejt 200 ha në zonën malore Reç-Vau i Dejës. 120 të rinj dhe të reja të NBSH-së «Perlat Rexhepi» morën zotim që të hapin jo 1 por 2 dynymë. Rinia shkollore mori inisiativën që gjatë këtij 5 vjeçari të hapë në zonën Zus-Oblikë 200 ha tokë të re. Po të kalosh nga këto zona sheh çdo ditë qindra të rinj dhe të reja që punojnë me vetmohim duke kthyer gadishmërinë e tyre në punë konkrete.

Edhe rinia fshatare përcaktoi detyrat e saj dhe u hodh në aksione konkrete. Të rinj e të reja të zonës fshore, iu ngjitën kodrave dhe maleve, mjaft prej tyre nga kooperativat bujqësore fshore të Dobraçit, Vrakës, Koplík-Qendër dhe Buzë-Ujit shkuan



në ndihmë të kooperativave bujqësore malore të Vri-  
thit, Bogës, Reçit dhe Lohe-Dedaj. Megjithë vështi-  
rësitë e mëdha që këta ndeshën, për arsye të kohës  
së keqe atmosferike, nga të ftohtit dhe dëborat e  
madhe, të rinjtë dhe të rejtat nuk deshën t'ia dijnë,  
por me një hov të paparë revolucionar punuan me  
vetmohim dhe u bënë shëmbull frymëzimi në ma-  
sën e rinisë të këtyre kooperativave. Fakti që vetëm  
300 të rinjtë e të rejtat që shkuan në ndihmë të  
kooperativave malore gjatë periudhës 1 mujore ha-  
pën më se 18 ha tokë të re, përveç punëve të tjera  
që kryen si bartje gurësh, hapje kanalesh, etj. e  
konkretizon këtë hov revolucionar.

Të rinjtë e të rejtat krahas punës zhvilluan  
edhe aktivitete të ndryshme mjaft interesante, si  
takime me bujq të vjetër, veteranë të luftës Na-  
cional-Çlirimtare, mbasdite tematike kushtuar të  
rinjve dhe të rejave të dalluar në aksion, informacio-  
ne politike, etj.

Por tregon ajo — problemi i ngjitjes së të rinj-  
ve dhe të rejave ndër kodra e male nuk ishte një  
aksion i thjeshtë. U desh të bëhej një punë mjaft  
e madhe edukative e politike e sidomos me të re-  
jat për t'i tërhequr ato të punonin në zonat e malë-  
sisë. Si vullnetare që isha me të rinjtë dhe të rejtat  
e kooperativës bujqësore Dobraq, do të flas pak se  
si e shtrua në këtë problem kaq të rëndësishëm,  
pengesat që ne ndeshëm tek prindërit e disa të re-  
jave dhe rezultatet e punës në mal. Në mbledhjen  
e parë të organizatës, për t'iu qepur kodrave e ma-  
leve, rezultati ishte shumë i mirë. E gjithë organizata  
shprehu unanimisht gadishmërinë e saj. Por ç'ndo-  
dhi më pas? Një pjesë e prindërve s'deshën t'i lejo-  
nin vajzat e tyre. Me këtë vështirësi organizata u

muar seriozisht. Vendosëm që të dërgojmë grupe të rinjsh e të rejash ndër familjet që nuk i lejonin vajzat të vinin në aksion. Këta të rinj e të reja, biseduan miqësisht me prindërit e vajzave duke u treguar atyre rëndësinë, jetën që bëhet në aksion, punën që bëhet atje dhe kujt i shërben kjo. Mbas kësaj pune u arrit rezultati i dëshiruar. Prindërit e kuptuan gabimin që kishin bërë dhe dhanë pëlqimin që edhe vajzat e tyre të merrnin pjesë në aksion.

Erdhi dita e nisjes. Të gjithë kooperativistët kishin dalë për të na përcjellë. Kudo dëgjoheshin porositi që prindërit na jepnin neve. «Punoni sa më shumë që të nderoni vehten dhe ne». Kur mbrijtëm në kooperativën bujqësore të Reçit kishin dalë edhe atje qindra kooperativistë për të na pritur.

Dita e parë e punës ishte, si të thuash, prova e parë për ne. Patëm mjaft të rinj e të reja që tejkaluan normën deri në masën 150 përqind. Disa nga ne merreshin me bartjen e gurëve me tezgë për të ndërtuar murin e taracës. Kishte disa fshatarë që thonin: «është dita e parë kjo, të shohim ditët e tjera». Por ne s'e ndryshuam ritmin gjatë gjithë punës vullnetare, bile ardhni duke u ngritur, megjithëse koha ishte shumë e keqe.

Mesatarja e të gjithë brigadës doli 156 përqind. Patëm nga ata që e realizuan normën deri 270 përqind. Ne hapëm 4 ha tokë të re, përveç punëve të tjera si bartje gurësh, hapje kanali, etj. Efekti i punës sonë që i madh, veçanërisht për të tërhequr me vehte në këtë stinë gjithë fshatarët në punë. Po u them një rast: Një ditë kishte rënë dëborë e madhe. Ne të gjithë po punonim në malin Beterat për hapjen e taracave. Mirëpo mbasadreke mbasi ne

kishim bërë pushimin, shohim një grua fshatare e cila po hapte tokën qilizëm. Ne e pyetëm si ndodhi kjo që ajo tashti po punonte. Ja se ç'na tha: «Isha tek furra e kooperativës. Hodha sytë në mal, por ç'të shoh, mali ziente nga puna juaj. Mendova me vehte: «Këta kanë ardhur nga Dobraçi e po punojnë në dëborë, kurse unë rri e bëj sehir «lashë bukën pa marrë dhe ja tashti po punoj me ju».

### **Eksperienca e tyre do të na vlejë edhe në të ardhmen**

Ne përfituam shumë prej tyre — ishin fjalët e para të Burhanit, mikpritësi i tyre.

Lajmi se në kooperativën tonë, në Reç të Shkodrës, tha ay, do të vinin të punonin të rinj vullnetarë nga Dobraçi dhe kooperativa të tjera të fushës u prit me gëzim nga të rinjtë e të rejat e kooperativës sonë. Organizata bazë e partisë, e rinisë dhe kryesia e kooperativës, morën të gjitha masat e nevojshme për t'i pritur sa më ngrohtë dhe për t'u krijuar kondita sa më të mira vullnetarëve. Që në ditën e parë të punës, megjithse të pa mësuar me terren të tillë malor, dobraçasit realizuan normat duke çuar në vend fjalën e dhënë dhe duke u bërë një shëmbull vetmohmimi në punë. As të ftohtit, as shiu i vazhdueshëm, as dëbora e shpeshtë që ra në këtë periudhë nuk i pengoi ata që të fillonin punën në mëngjes heret e ta linin në orë të vona të natës. Ditën kënga shoqërohej me tingujt e kazmave dhe të lopatave, kurse natën me tingujt e fizarmonikës, violinës e çiftelisë vëndase. Reçi u bë më i gjallë,

më i gëzueshëm, ai jetonte në festë. Gjatë kësaj kohe ata u njohën me historikun e fshatit e të kooperativës. Me organizatën e rinisë e me të gjithë malësorët, në shtëpiat e të cilëve fjetën për një muaj rresht, të rinjtë tanë u bënë shokë e miq me të rinjtë dobraças. Ata na dhanë ndihmë të gjithanëshme: hapën tokë të re, 4 ha dhe transportuan 4400 kv gurë, që janë baraz me 176 m<sup>2</sup> mur. Kjo për kooperativën tonë ishte një ndihmë shumë e madhe, se reçasit janë të vuajtur për një pëllëmbë tokë. Ne fituam shumë nga eksperiencia e tyre e punës që do të na vlejë edhe në të ardhmen.

### «Aty u çfaqën tiparet e të riut revolucionar»

Ditët që kaluam në malin e Dhëmbelit shumica e të cilave qenë me reshje shiu dhe dëbore, qenë ditë prove të vendosmërisë sonë. kështu u shpreh Andoni nga kooperativa bujqësore «24 Maj» — Përmet. Të ftçhtit dhe era e cila në disa raste rrëzoi dhe çadrat, shiu që binte pa pushim nuk na lejonin të bënim një punë me rendiment. Punuam në një terren të vështirë, kudo kishte gurë, rrënjë dhe kërcunj. Të rinjve iu desh që çdo ditë të luftonin me to. Dhe në këtë punë të madhe u çfaqën tiparet e larta të të riut tonë. Atje të rinjtë dhe të rejat patën marrëdhënie shëmbëllore shoqërore. Të rinjtë përkujdeseshin si vëllezër për vajzat; ata u mblihdnin dru, kujdeseshin për zjarrin, shumë herë kur shihnin se vajzat punonin në terren të vështirë, ndrronin vendin me to. Në aksion u mbajt qëndrim kritik ndaj të metave. Aty ata kaluan një jetë të thjeshtë e pa pretendime. Nuk pati ankime dhe

qarje. Gazeta e murit dilte rregullisht. Artikujt trajtonin probleme të jetës në aksion pa u shkëputur nga jeta e vendit. Heroizmi i komunistit Adem Reka u bë i njohur. Atij i kushtohej dhe një artikull i gazetës së murit. U bënë takime me ish partizanët, takim dhe punë e përbashkët me të rinjtë puntorë të Përmetit, etj.

Pati dhe një rast interesant. Një e re duke iu bindur në mënyrë të pandërgjegjshme urdhërave dhe presionit të prindërve të saj nuk erdhi me ne që ditën e parë në mal. Në momentin, kur ajo pa karvanin e shokëve që po i ngjiteshin malit përpjetë, nuk priti më, por kërkoi nga prindërit me insistim që ta lejonin të shkonte tek shokët dhe shoqet e saj. Por prindërit nuk e lanë ditën e parë. Të nesërmen ajo përsëriti kërkesën e saj dhe kur pa se prindërit refuzuan prapë, ajo me guxim ju ngjiti malit dhe erdhi në gjirin tonë. Pas pak ditësh atje erdhi babai i saj i cili u habit me vrullin tonë, me frymën e organizimit, me kujdesin e madh që tregonin për shoku-shokun. Plaku iku i qetë dhe u bind sepse nuk kishte pse të merakosej për të bijën.

### «Punuam si revolucionarë të vërtetë»

«Në këtë aksion konkret të rinjtë e të rejtat e kooperativës sonë, kanë punuar si revolucionarë të vërtetë, me një entuziazëm dhe vrull që kurrë nuk ishte provuar nga ne. Qëndrimi dhe puna e të rinjve tanë theu edhe ndonjë mentalitet të fshatarëve të cilët nuk mund të besonin se në kushte të këqia natyrale ne mund të punonim të realizonim dhe të tejkalonim normën. 15 ditët e aksionit tonë nuk ki-

shin vetëm qëllim punën. Ne aty krijuam një ambient të ngrohtë shoqëror, njohëm thellë karakterin e njëri tjetrit, kalitëm në ndërgjegjen tonë shpirtin e atij revolucionari që kërkon partia.

Ne kemi mbetur jashtëzakonisht të kënaqur nga pritja shumë e ngrohtë e përzemërt dhe familjare që na u bë nga ana e kooperativistëve të Domje-Malit. Ajo na bindi për traditën shekullore të mikpritjes shqiptare. Ne atje krijuam familjet tona të dyta, prindër, vëllezër e motra të dyta. Me bukë e kripë ne u vëllazëruam me të rinjtë e të rejat e kooperativës. Aty ne jetuam ato çka kemi dëgjuar nga të parët tanë dhe çka kemi lexuar nëpër librat për traditat shqiptare, aty ne u kalitëm fizikisht e dolëm më të fortë. Ne, u munduam të ndihmonim shoqet tona të fshatit, për të krijuar një ambient më të kulturuar në shtëpitë e tyre, i ftuam ato në shtëpitë tona dhe u premtuam se në të ardhmen do të organizojmë punë të përbashkët e eskursionë për të parë nga afër frutet e punës së seicilit. Përveç kësaj gjatë kohës së qëndrimit tonë në fshat ne organizuam programe kulturore sëbashku me fshatarët, duke e ndjerë vehten kështu si në shtëpitë tona».

Këto ishin fjalët që tha Fitorja, një e re nga organizatat e BRPSH të kooperativës artistike «Migjeni» në Tiranë.

### U shpallën 40 sulmues

Unë jam punonjës në NSHFMO-Durrës tha Vlasi dhe punova sëbashku me 182 të rinj e të reja, që formuan brigadën e parë vullnetare me fla-

murin e kuq të shkruar me emrin e heroit të punës socialiste Adem Reka, nga të cilët 120 ishin të reja.

Brigada kishte shtabin e saj, komisarin dhe komandantin. Kishim program pune, rregull dhe disiplinë.

Çdo mëngjes bënim analizën e punës së djeshme, ndarjen e flamurëve të kompanisë, skuadrës dhe flamurin «i ri revolucionar» një herë në 3 ditë, ndërsa sulmuesit e aksionit i shpallnim 1 herë në 10 ditë.

Në brigadën tonë të gjithë të rinjtë ishin të mobilizuar dhe çdo ditë ne tejkalonim normën e kooperativistit. Në radhët tona kishim të rinj që gjatë gjithë muajit e kanë tejkaluar normën me një përqindje të madhe si Misiri, që bënte disa herë 4-5 norma në ditë, apo Havaja e organizatës së rinisë të NISH Gomës, Telija nga Kavaja, Maksimi i kantierit detar që realizonin normën 150 përqind çdo ditë, etj. etj.

Në përfundim të aksionit ne shpallëm 40 sulmuesa. U dhamë 32 fletë lavdërimi aksionistëve më të dalluar.

Krah për krah me ne punuan dhe të rinjtë e të rejat fshatare? Në aksion ne bëmë aktivitete të gjëra politike e kulture. Atje organizuam ditën e blerjes së literaturës politike dhe konkretisht fjalimin e shokut Enver dhe diskutuam problemet që ngrihen aty për rininë.

Në frontin e punës ne bëmë një bisedë me një kooperativist në moshë të vjetër, i cili na foli mbi historikun e fshatit ku ne punuam një muaj rresht.

Punuam thirrjen e K.Q. të BRPSH. Të gjithë aksionistët u shprehën dhe dhanë fjalën se këtë vrull revolucionar, frymë dhe miqësi në aksion, do

ta çojnë dhe nëpër organizatat bazë të rinisë së ndërmarrjeve.

Ne u njohëm me jetën e të riut fshatar dhe me familjet e tyre, influencuam për zhdukjen e disa zakoneve prapanike duke dhënë shëmbullin tonë me punë dhe pastërti morale. Puna jonë në fshat na bëri që ta çmojmë drejt punën e fshatarit.

### «Shëmbulli ynë i bindi fshatarët e Shupalit»

«Puna jonë atje në malet e Shupalit, në dëborë e në shi, i bindi për ditë e më shumë fshatarët kooperativistë se dimri nuk është një stinë pushimi por një periudhë ku mund të ndërmarrin shumë punë të vlefshme. Kështu pas disa ditëve u arrit që ne sëbashku t'i qepemi malit të Shupalit. Atje nxirrim gurë, bënim taraca, hapnim toka të reja.

Detyra jonë ishte që jo vetëm të punonim por dhe të propagandonim tek fshatarët mbi dobinë e punës kolektive, mbi mënyrën e jetesës duke ia përshatur konditave të fshatit, mbi rregullin dhe pastërtinë që duhet të mbajnë ata në shtëpi dhe shoqëri dhe mbi probleme të tjera. Duhet të theksoj se gjithë grupi ynë i përbërë prej 21 vetash çdo natë mblidhej nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe bashkë me ata kalonim disa orë duke kënduar këngë revolucionare, popullore dhe valle popullore. Ndonjë natë kur ne nuk mblidheshim, fshatarët pyesnin: — ku janë djemtë dhe vajzat tona që nuk ndihen sonte?

Të rinjtë tanë punuan me vetmohim duke mposhtur vështirësitë e natyrës: shiun, dëborën, akullin. Në kohë ngrice punonim në këtë mënyrë: dy nga shokët tanë me kazma punonin sipërfaqen e tokës



dhe të tjerë pastaj punonin me bela, dhe puna nuk ndalej.

Nga aksioni ne mësuam shumë gjëra si zakonet, veshjet si dhe historinë e fshatit gjatë luftës Nacional-Çlirimtare. Ne dëgjuaam nga fshatarët për luftën Nacional-Çlirimtare; për sakrificat, për guximin e pashëmbullt që treguan partizanët. Mjaft prej tyre mbanin mend edhe sot emrat e partizanëve trima që kishin ndenjur në shtëpitë e tyre. Këto na frymëzonin në punën tonë», — e përfundoi fjalën e tij Ferdinandi nga N.I.SH. Pelicëria — Tiranë.

## LE TA ZGJEROJMË AKOMA MË TEPËR KËTË AKSION.

Në aksionin e hapjes së tokave të reja në zonat kodrinore e malore të marrin pjesë sa më shumë të rinj dhe të reja nga kooperativat e fushës e nga qendrat e punës dhe të prodhimit. Gjatë kohës që të rinjtë shkojnë në zonat malore shokët e tyre duhet të marrin përsipër që të realizojnë në kooperativat apo qendrën e punës edhe detyrat e shokëve. Kjo do të rrisë akoma më shumë ndjenjën e solidaritetit kolektiv e nuk do të lejojë që të dëmtohet sado pak plani i prodhimit. Është bërë e zakonëshme që të rinjtë dhe të rejat e kooperativës së fushës dhe të qendrave të punës kur kthehen raportojnë në organizatat e tyre mbi punën që kanë bërë në aksion e forma të tjera si kjo. Le t'i organizojmë e përdorim më mirë këto forma në mënyrë që ato të bëhen shkas për frymëzimin e qindra të rinjve të tjerë për t'ju qepur kodrave e maleve.

Puna e të rinjve të kooperativës të fushës dhe qendrave të punës dhe të prodhimit është mjaft e dobishme dhe në frontin e tyre të punës prandaj ne nuk duhet të lejojmë që asnjë minutë nga kjo kohë

e çmuar e vullnetarëve të mos shkojë kot. Komitetet e rinisë në bashkëpunim me komitetet ekzekutive të k.p. të rretheve, të përcaktojnë me kohë objektet ku do të punojë rinia. Kryesisht të rinjtë vullnetarë duhet të punojnë në hapjen e tokave të reja.

Një gadishmëri revolucionare për t'ju qepur kodrave e maleve u shpreh edhe nga mjaft kuadro drejtuese të kooperativave bujqësore e specialistë të ndryshëm të bujqësisë si agronomë, veterinerë, etj. Ata dhanë një kontribut të madh në arritjen e rezultateve të mira nga rinia në aksione.

Edhe në të ardhmen pjesëmarrja, njohuritë dhe eksperiencia e tyre është dhe do të mbetet për rininë një ndihmë e shëmbull i madh.

Parullën e Kongresit të pestë «t'u qepemi kodrave e maleve», duhet ta kuptojmë më gjerë. Mijra të rinj të fushës dhe të rinj puntorë ju qepën kodrave e maleve duke punuar vullnetarisht dhanë kontributin e tyre për hapjen e tokave të reja në male. Por krahas kësaj e në radhë të parë maleve e kodrave duhet t'u qepet rinia e vetë kooperativave e fshatrave malore. Ashtu siç kanë vepruar qindra e mijra të rinj të kooperativave bujqësore të Korçës, siç kanë vepruar të rinjtë e të rejat e kooperativave të Starovës e të Poshnjës të rrethit të Beratit, të Gjirokastrës, të Përmetit e të shumë kooperativave të tjera. Le të jetë rinia flamurtare e këtij aksioni të madh revolucionar e nën shëmbullin e sajë të tërheqë gjithë masën e kooperativistëve e të punonjësve të tjerë.

Krahas punës për hapjen e tokave të reja, në zonat kodrinore e malore rinia duhet të çojë atje mënyrën e re të jetesës, të luftojë zakonet e vjetra

e prapanike të kultivojë në fshatarët e atyre zonave zakonet e reja të punës e të jetës sonë socialiste.

**(Nga përshëndetja e Komitetit Qëndror të BRPSH-së, mbajtur nga shoqja Haxhire Brahja, sekretare e KQ të BRPSH-së, në takimin kombëtar të përfaqësuesve të brigadave vullnetare të rinisë që iu qepën kodrave e maleve për hapjen e tokave të reja).**

## **E SIGUROJMË EDHE NJË HERË PARTINË SE KODRAT DHE MALET DO T'I LULËZOJMË**

«Asntu si për gjithë të rinjtë e të rejat e Shqipërisë, edhe për ne mësimit e Partisë sonë të dashur, janë si një fener i madh që ndriçojnë horizontet e lavdishme të së ardhmes dhe na mbushin me besim e guxim për të shkuar përpara në rrugën e revolucionit si një brez i denjë revolucionarësh. Fjala e shokut Enver nga tribuna e Kongresit të 5-të për t'iu qepur kodrave dhe maleve, që si një kushtrim për gjithë brezin e ri dhe ne, pa marrë parasysh asnjë vështirësi, asnjë pengesë u nisëm drejt maleve të larta për t'i bërë ata të begatshëm dhe të lulëzuar si dhe fushat. Vrulli revolucionar i rinisë sonë ndjehet kudo në kodra e male, në shkrepë të thepisura e maja. Ne do ta çojmë më përpara këtë hov të madh; mijra e mijra të rinj e të reja nga fusha do të shkojnë në ndihmë të kooperativave malore, mijra e mijra nga ne do të hapin toka të reja në kooperativat tona, në kodrat dhe malet tona. Në këtë luftë vigane për ta bërë atdheun sa më të begatshëm e sa më të fortë, ne do të kalitemi më shumë, do të ngremë lart e do të çojmë më tej traditat e lavdishme të aksioneve të rinisë sonë.

E sigurojmë edhe një herë Partinë se kodrat dhe malet do t'i lulëzojmë, do t'i kthejmë në toka buke

e do t'i bëjmë të begatëshme si fushat. Forca që na çon përpara dhe na bën të sulmojmë me guxim janë mësimet e urta të partisë e udhëheqësit tonë të dashur shokut Enver Hoxha. Ne i betohemi se do të jemi në vijën e parë të luftës për ta bërë Shqipërinë tonë edhe më të fortë, edhe më të begatëshme, edhe më të pathyeshme. S'ka e as do të ketë forcë që të na ndalë në marshimin tonë fitimtar, shpresat dhe ëndrrat e imperialistëve dhe revizionistëve do të dështojnë.

Rruga jonë është: përpara, lart! Dhe ne, si gjithë brezi i ri i vendit tonë do të shkojmë gjithmonë përpara, vigjilentë e sy patrembur, ashtu siç na mëson Partia dhe shoku Enver».

**(Nga telegrami që i dërgoi Komitetit Qëndror të PPSH, takimi kombëtar i vullnetarëve që iu qepën kodrave dhe maleve).**

## **NJË HAP I RI PËRPARA NË LËVIZJEN E RINISË PËR T'IU QEPUR KODRAVE E MALEVE.**

### **SEKRETARIT TË PARË TË KOMITETIT QËNDROR TË PPSH**

I dashur shoku Enver!

Ne, 32 të rejtat dhe të rinjtë e organizatës së rinisë të kooperativës së kombinuar të artizanatit të Elbasanit, ju njoftojmë me gëzim se vendimet historike të Kongresit të 5-të të partisë dhe thirrja e madhe që ju i drejtuar plot besim brezit tonë nga tribuna e kongresit për t'iu qepur kodrave e maleve, për t'i zbukuruar dhe bërë ato pjellore si dhe fushat, janë bërë për ne burim i madh frymëzimi dhe hovi revolucionar. Ato kanë mbushur me gëzim zemrat tona dhe na shtuan besimin dhe forcat për fitoren e betejës së madhe — realizimin e detyrave të planit të katërt pesëvjeçar.

Ne jemi të rinj dhe nuk e kemi jetuar të kaluarën e popullit tonë, as vitet e stuhishme të luftës, kur rinia dhe patriotët e Shqipërisë, duke patur në gjirin e tyre zjarrin e revolucionit që ndezi partia për lirinë e këtij populli, sulmonin si luanë në çdo strofkë armikun e urryer të vatrës shqiptare. Ne nuk patëm fatin të rrjeshtoheshim në radhët e partizanëve, të cilët me aksion çanin kryq e tër-

thor Atdheun e pushtuar dhe, ndonëse të paveshur e të pangrënë, të pambathur e këmbë gjakosur, luftonin si heronj dhe mbillnin lirinë kudo ku shkelnin. Megjithëse nuk e jetuam, ne njohëm mirë dhe çmojmë së tepërmi sakrificat që u janë dashur të bëjnë baballarëve e nënave, motrave e vëllezërve tanë të rritur.

Ne jemi të vendosur të ecim në gjurmat e tyre, të bëhemi si ata revolucionarë, prandaj jemi gati t'u qepemi kodrave e maleve. Tani është radha jonë.

Organizata jonë e rinisë, duke diskutuar rreth thirrjes së komitetit të partisë të rrethit drejtuar komunistëve, punëtorëve dhe rinisë së rrethit tonë, shprehu e para gadishmërinë për të shkuar dy deri tre vjet për të punuar me ditëpune në kooperativat e reja malore. Duke marrë këtë inisiativë, ne e dimë mirë se për dy-tre vjet do të lëmë familjet, rrogat tona, bulevardin e kinematë, por kjo nuk na pengon aspak. Për ne, i dashur mësues dhe baba shoku Enver, të gjitha këto nuk vlejnë, nuk kanë asnjë kuptim përpara nevojës së madhe që kemi për t'u kalitur me vështirësitë, për t'u njohur më afër me popullin, dhe sidomos me malësin, tonë trim, besnik, punëtor dhe bujar. Të gjitha ato nuk na duhen kur malësia ka aq shumë bukuri dhe pastërti. Ne nuk duam më të shëtitim bulevardeve, por shtigjeve partizane. Ne duam dhe do të bëjmë përsëri që malet tona kreshnike të buçasin nga kënga e rinisë, ashtu si dikur nga marshet e brigadave.

Me marrjen e inisiativës për të punuar dy deri tre vjet me ditëpune në kooperativat malore, ne jemi të bindur se atje në male, duke jetuar dhe punuar bashkë me malësorët tanë, do të forcojmë më tej lidhjet e klasës punëtore e të qytetit me fshatin



dhe, në luftë me vështirësitë, do të kalitemi si revolucionarë.

Duke shkuar në malësi, ne jemi të bindur se do të mësojmë shumë, do të pastrojmë nga ndërgjegja jonë rehatinë, egoizmin dhe interesin e ngushtë personal.

Ne ju sigurojmë, i dashur, shoku Enver, dhe zotohemi se atje në fshatrat e malësisë:

1) Do të përpiqemi me të gjitha forcat që të njohim sa më mirë jetën, zakonet dhe traditat e mira të malësorëve tanë, për të mësuar sa më shumë prej tyre.

2) Bashkë me shoqet dhe shokët fshatarë, do të vëmë të gjitha forcat në punët bujqësore, për forcimin ekonomik dhe organizativ të kooperativave të reja, dhe, duke punuar kështu, do të bëhemi edhe vetë bujq të mirë.

3. Do të punojmë me të gjitha fuqitë për forcimin dhe gjallërimin e organizatës së rinisë dhe sidomos për gjallërimin e jetës së të rejave.

4. Do të punojmë pa u lodhur për përmirësimin e kushteve të jetesës, gjallërimin e jetës politiko-kulturale dhe sociale të fshatit dhe për çrënjosjen e zakoneve prapanike e besimeve fetare, që akoma zënë shumë vend në ndërgjegjen e malësorëve tanë.

Jemi të bindur se, nën udhëheqjen e partisë sonë shqipe mali me ju në krye, s'ka forcë në botë të ndalë marshimin tonë guximtar në malet kreshnike shqiptare.

Ne u bëjmë thirrje të gjithë të rejave dhe të rinjve të Shqipërisë që, në përgjigje të aksionit tonë, të ngjeshin radhët e brigadave të rinisë për të

derdhur djersën atje në male, në foletë e përjetëshme të partizanëve dhe lirisë.

Rrofsh sa malet tona, shoku Enver!

NGA TË REJAT DHE TË RINJTË E  
KOOPERATIVËS SË ARTIZANATIT  
TË KOMBINUAR NË ELBASAN

**Elbasan, 7-2-1967.**

## SI LINDI INISIATIVA REVOLUCIONARE E ARTIZANËVE TË RINJ?

Shkëndijën e parë e dha një nga antaret e organizatës, Hatifeti. Para disa ditësh kjo vajzë e thjeshtë punëtore shkoi në komitetin e partisë së rrethit. Çfarë donte ajo atje? Çfarë e preokuponte? Kishte dëshirë të shkonte vullnetare për të punuar në zonat e largëta malore 2 ose 3 vjet. Ja pra pse kishte shkuar ajo atje: t'i shprehte komitetit të partisë një dëshirë që i vlonte në shpirt.

— Dua të punoj 2 ose edhe 3 vjet, — i tha ajo sekretarit të partisë. Jo me rrogë, por si antare e kooperativës, me ditë pune.

Inisiativën e Hatifetit, organizata e mësoi menjëherë dhe ngjalli midis antarëve të organizatës një interesim të veçantë. Antarët e organizatës i thoshin njëri tjetrit: «I lumtë Hatifetes!» Organizata e rinisë vendosi ta diskutojë këtë inisiativë revolucionare në mbledhjen e saj. Dhe u mbledhën antarët e kësaj organizate.

Ishte një mbledhje revolucionare, luftarake, ku gjithë të rinjtë e të rejat donin të jepnin mendimin e tyre. E mori fjalën e para Hatifeti, ajo u tregoi atyre se ishin vendimet e Kongresit, ishin porositë e udhëheqësit tonë të dashur, që e shtynë atë të lerë qytetin e të shkojë në kooperativën më të largët,

në çdo zonë ku do ta dërgojë komiteti i partisë së rrethit. Dhe pas saj, folën me radhë Petriti, Hasani, Remziu, Liria, Meremja, etj. Nga zemra e tyre dilnin fjalët: unë jam gati... unë jam gati... unë jam gati... Fjalët e tyre i përngjishnin më fort refrenit të një kënge revolucionarësh të kënduar me gjithë zemër se sa një diskutimi.

Kështu pra e gjithë organizata e përqafoi me entuziazëm inisiativën revolucionare të Hatifetit.

## KOMITETIT QËNDROR TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË SHOKUT ENVER HOXHA

Të frymëzuar nga vendimet historike të Kongresit të 5-të të PPSH dhe në vazhdim të punës sonë për të vënë në jetë parullën e madhe që hodhi partia t'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si fushat, sot ne, 70 të rinj e të reja të organizatës së rinisë të uzinës së telave elektrike, shprehim me entuziazëm pa marrë parasysh asnjë vështirësi, gatishmërinë që të punojmë një vit në kooperativat e reja malore të porsakrijuara të Shllakut, Dukagjinit, Vermoshit e të tjera, me qëllim që të punojmë dhe të kalitemi si revolucionarë të rinj. Ne, punëtorët e punëtoret e reja, me frymën revolucionare të klasës sonë dhe me hovin rinor, do të çojmë në bjeshkët tona të larta mësimet dritëdhënëse të partisë sonë nënë, do të ndihmojmë në gjallërimin e organizatave të rinisë, në përhapjen e kulturës e të përparimit, duke u lidhur fort me shokët tanë fshatarë atje në male, në taracat, në shtëpitë dhe stanet e malësorëve trima, do të kalitemi me frymë komuniste, me tiparet

heroike të malësorëve tanë. Atje do të bëhemi të çeliktë si vetë malet tona.

## ORGANIZATA E RINISË E UZINËS SË TELAVE ELEKTRIKE NË SHKODËR

**Shkodër, 7-2-1967.**

### TURNI I PARË

...Pak ditë më parë, uzina e telave elektrike, krenaria e industrisë së rrethit të Shkodrës dërgoi turnin e parë të të rinjve për hapjen e taracave. Gurë të mëdhenj, dhjetra dhe qindra kilogramësh, çvendosin nga mali këta djem e vajza energjike dhe vihen në garë se kush do të punojë më mirë, më shpejt, më shumë. Në këtë valë pune entuziaste lindi inisiativa e re.

Duke punuar me vull, Liria ishte skuqë e djersitë. Pranë saj punonin edhe tri shoqet e saja, Sabaheti, Veneranda dhe Maria.

— E ke marrë me vull, moj vajzë! Më ngadalë se mos sëmuresh! — i drejtohet Fuati Liries.

Vajza, duke mendue se Fuati tallet, i përgjigjet:

— Ti, rrej veten, shoku sekretar! Unë nuk jam nga ato që sëmurem lehtë! Jam e kalitun me punën.

Ai buzëqesh dhe shton:

— Unë nuk bëj shaka! Ti je djersitë...

Tashti duhet të djersitemi të gjithë. Djersa jonë do t'i shtojë tokat e bukës, do t'i bajë malet

pjellore si dhe fushat! — ndërhyh Sabaheti. — Është porosi e Kongresit të 5-të...

Biseda lindi bisedën. Vajzat folën për suksesin që kanë arritur lokalitetet e thella malore, Tamara, Dukagjini, Shllaku... që përfunduan kolektivizimin me sukses.

— Sa nevojë kanë tani atje kooperativat për ndihmë! — tha Liria.

— A do të kishe shkuar ti Lirije në Dukagjin me punue me malësorët? — i tha Fuati.

— Që sot! — u përgjegj vajza.

— Me punue një muaj?

— Pse një muaj? Një vit!

— Vërtet thua?

— Pse të tallem? Unë s'e harroj porosinë e Kongresit që rinia të bëhet banore e ardhëshme e maleve!

— Po ju vajza, ç'thoni?

— Jemi gati! — u përgjegj Sabaheti.

— Bile që nesër! — plotësuan Veneranda me Marijen.

Fuati i entuziazmuar u tha:

— Po sikur ne, të katër të merrnim një inisiativë të tillë që të shkojmë për një vit në Dukagjin, Shllak ose Kelmend, a do të na e përkrahte rinia a uzinës? Si thoni?

— Kjo është një ide e bukur! — tha Sabaheti.

— Ta shpallim që sonte, në mbledhjen e organizatës! — shtoi Liria.

— Sa për vajzat janë gati. I njoh unë sa të zjarrrta janë, — tha Marija.

U tha dhe u vendos. Të rinjtë vazhduan punën më me hov se përpara. Gjithë grupi që punonte e mori vesh inisiativën dhe e përkrahu që në vend.

Në mbrëmje u mbledhën të gjithë të rinjtë e uzinës. Para mbledhjes Fuati foli me zv/sekretarin e partisë të uzinës, i cili jo vetëm e përkrahu, por i përgëzoi inisiatorët.

— Ju lumtë! — tha — ju keni menduar si revolucionarë! Inisiativën tuaj do ta përqafojmë edhe ne, komunistët e uzinës.

Mbledhja e asaj mbrëmje që më e zjarrra që kish bërë ndonjëherë rinia e uzinës. Të rinjtë, të entuziazmuar e përkrahën pa rezerva inisiativën dhe brenda gjysmë ore 70 të rinj e të reja dhanë fjalën për të shkuar në kooperativat malore për një vit.

Të nesërmen, Shkodra e mori vesh inisiativën pa u botuar ende në gazetë. Kudo, në qendra pune, të rinjtë diskutonin për vendimin revolucionar të rinisë së uzinës. U zhvilluan mbledhje të jashtëzakonëshme në çdo ndërmarrje dhe brenda dy ditëve inisiativa e re u përkrah nga gjithë rinia punëtore e qytetit. Në komitetin e rinisë vinin njoftimet njëri pas tjetrit nga organizatat e rinisë.

— NISH Letra — 120 të rinj e të reja.

— Cigaret — 80.

— NTLAP — 60.

— Uzina mekanike — 23.

— NSHRAKU — 32...

E kështu me radhë. Brenda 2 ditëve numuri i përgjithshëm i të rinjve që ishin regjistruar për të shkuar në zonat malore arriti shifrën 480. Dhe jo vetëm kaqë, por inisiativa ishte çuar më tej nga shumë të rinj. Dyzet të rinj e të reja shpallnin se do të jetonin e punonin në Dukagjin, Shllak e Kelmend 3-5 vjet, 350 të tjerë nga 2 vjet.

Kështu iu përgjegj rinia revolucionare puntore



e Shkodrës shokëve e shoqeve të tyre të uzinës së telit.

\* \* \*

Gadishmëria që shprehën të rinjtë e të rejat e kooperativës së kombinuar të artizanatit të Elbasanit dhe ata të uzinës së telëve elektrike në Shkodër për të shkuar e punuar 2-3 vjet me ditë pune në kooperativat malore të porsakrijuara është me të vërtetë një inisiativë e shkëlqyer revolucionare jehona e së cilës tanimë është përhapur e ka pushtuar mendjet e ndjenjat e qindra e mijra të rinjve e të rejave të vendit tonë. Turnet e para, që u nisën nga shumë rrethe do t'i pasojnë me dhjetra turne të tjerë.

## PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
T'u qepemi kodrave e maleve t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si dhe fushat .....	3
Miq nga fusha .....	7
Inisiativë dhe aksion i madh revolucionar .....	12
Drejt maleve për në kooperativat e reja .....	21
Ashtu si partizanët .....	30
Në malet e Skraparit .....	33
Flamujt e kuq valëviten mbi Bickë .....	40
Themelin djersë, kulmin bukë .....	44
Rinia e fshatit drejt malit .....	48
Rinia e Pirgut sulmon lartësitë e fshatit .....	52
Vrulli yt rini, do t'i bëjë malet fusha .....	56
Malet nuk flenë nën dëborë .....	60
Nga tribuna e takimit kombëtar të të rinjve që sulmon kodrat dhe malet .....	64
Le ta zgjerojmë akoma më tepër këtë aksion .....	74
E sigurojmë edhe një herë partinë se kodrat dhe malet do t'i lulëzojmë .....	77
Një hap i ri përpara në lëvizjen e rinisë për t'iu qepur kodrave e maleve .....	79
Si lindi inisiativa revolucionare e artizanëve të rinj..	83